

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
ZVRPP TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me objekt:“Mbi procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2013 dhe për çështje të veçanta para vitit 2011dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 178, datë 29.12.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 703/19, datë 29.12.2015, i ka rekomanduar z. Ilirjan Muho, Kryeregjistrues i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në të cilën përfshihet ZVRPP Tiranë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014 dhe 6/mujorin e I-rë 2015 ka patur bashkëpunim të pamjaftueshëm, ndërmjet ZVRPP Tiranë dhe KVVTP Prefekti Qarkut Tiranë, reflektuar në konstatimet e mëposhtme:

a. 1. KVVTP, pranë Prefektit të Qarkut Tiranë, **për periudhën 2012-6/mujori I-rë vitit 2015** i ka drejtuar **ZVRPP Tiranë 2209 kërkesa** për informacion, verifikim, konfirmim të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore, për të cilat nga ana e ZVRPP Tiranë, janë kthyer përgjigje për **836 kërkesa (ose 37%), nuk ka kthyer përgjigje për 1373 kërkesa (ose 63%) me tejkalim afati deri 5 vjet, 836 përgjigjet**, janë kthyer me vonesa dhe në tejkalim të afatit, nga disa ditë deri në 10 muaj, pasqyruar në tabelën emërtuar **“Tabela e përgjigjeve të kërkesave të KVVTP-ZVRPP për periudhën 2012- 6/muj i-rë 2015”**; veprime këto në kundërshtim me KPA me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë e Paluajtshme të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”.

2.-Mos dhënia e përgjigjeve për 1373 kërkesa dhe shkelja afateve ligjore të kthimit të përgjigjeve janë me pasoja në mos pasqyrimin e ngjarjeve në KPP, parandalimin e transaksioneve, rritjen e praktikave në proces me aplikime të papërfunduara, vonesat në regjistrim të Pasurive bujqësore, praktika në kundërshtim me nenet 59, 60 dhe 74, si dhe në mos përmbushje të funksionit të ZVRPP përcaktuar në nenet 19, 20 dhe 25 të ligjit nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

3. Mungesa e dokumentacionit fizik në arkivë i **2209 kërkesave**, lënia në përdorim të specialistëve të zonave, mos lidhja e kërkesës në dosje të veçanta përfshirë gjithë dokumentacionin shoqërues deri ne përfundimin e Vendimmarrjes dhe mos dorëzimi në arkiv me vonesa deri në 5 vjet, praktika që janë në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për Arkivat”, dhe për shkeljen e afatit 1 muajor të KPA, me Urdhrat e regjistruesit, dhe me rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për Punën në ZVRPP”, të ndryshuar dhe me Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore ne ZRPP”, dhe që ngarkon me përgjegjësi Regjistruesit sipas viteve si dhe

përgjegjësit e specialistët e zonave, përcaktuar në tabelën e mësipërme emërtuar “Personat përgjegjës për kërkesat pa përgjigje ndaj KVVTP dhe për përgjigje të vonuara 2012-2015”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, për të inventarizuar dhe çelur dosjet përkatëse për **2209 kërkesa** për informacion, verifikim, konfirmim të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore të KVVTP drejtuar ZVRPP duke kthyer shkresat origjinale në arkivë dhe për **1373 kërkesa** ku nga ZVRPP Tiranë nuk janë kthyer përgjigje në shkelje të afateve ligjore, të zbatohen procedurat dhe të filloje pasqyrimi në KPP deri në zgjidhjen e plotë ligjore për regjistrimin e pasurive bujqësore, të kthimit të përgjigjeve duke pasqyruar ngjarjet në KPP, me synim parandalimin e transaksioneve, uljen e praktikave në proces me aplikime të papërfunduara, eliminimin e vonesave në regjistrim të Pasurive bujqësore, pasqyruar në “Tabela e përgjigjeve të kërkesave të KVVTP-ZVRPP për periudhën 2012-6/muj I-rë 2015”, “Kërkesa, Projekt vendime dhe Vendime të KVVTP për ZVRPP për vitet 2012-6/mujori I-rë 2015”.

2. Gjetje:

a. ZVRPP Tiranë për periudhën 2012-6/mujori I-rë vitit 2015 i ka drejtuar KVVTP, pranë Prefektit të Qarkut Tiranë, **235 kërkesa** për verifikim, vlerësim të Titujve të Pronësisë së tokës bujqësore, për të cilat KVVTP Prefektit të Qarkut Tiranë ka kthyer përgjigje për **38 kërkesa, (ose 16%), nuk ka kthyer përgjigje prej 5 vjetësh, për 197 kërkesa (ose 84%), duke tejkalluar afatin 1 mujor; ndërsa të 38 përgjigjet janë kthyer me vonesa dhe në tejkallim të afatit nga disa ditë deri në 3-4 muaj**, pasqyruar në tabelën emërtuar “Tabela e përgjigjeve të kërkesave të ZVRPP -KVVTP për periudhën 2012- 6/mujori I-rë 2015”; veprime këto në kundërshtim me KPA me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë, të Paluajtshme, të Fituara me Atin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, që ngarkojnë me përgjegjësi Strukturat e KVVTP, por dhe personat e ZVRPP që nuk kanë rikërkuar më tej, përcaktuar sipas tabelave “*Kërkesa të ZVRPP Tiranë drejtuar KVVTP për vitet 2012-6/mujori I-rë 2015*”, bashkëlidhur.

b.-Mos dhënia e përgjigjeve për **197 kërkesa** dhe shkelja afateve ligjore të kthimit të përgjigjeve janë me pasoja në mos pasqyrimin e ngjarjeve në KPP, parandalimin e transaksioneve, rritjen e praktikave në proces me aplikime të papërfunduara, vonesat në regjistrim të Pasurive bujqësore, pra në kundërshtim me nenet 59, 60 dhe 74, si dhe në mos përmbushje të funksionit të ZVRPP përcaktuar në nenet 19, 20 dhe 25 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pasqyruar nga auditimi sipas tabelave “*Kërkesa të ZVRPP Tiranë drejtuar KVVTP për vitet 2012-6/mujori I-rë 2015*”, me **29 fletë** lidhur me vonesat në përgjigjet e dhëna pasqyruar në tabelën “*Personat përgjegjës për kërkesat e ZVRPP pa përgjigje nga KVVTP dhe me përgjigje të vonuara 2012-2015*”.

Gjithashtu, rezulton bashkëpunim i pamjaftueshëm i KVVTP-së, në drejtim të bashkëpunimit me ZVRPP Tiranë, shkelje e afateve dhe procedurave të KPA, dhe mos reagim i ZVRPP Tiranë, për ta prezantuar problemin në Komisionin Qeveritar të Tokës dhe Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës, mosveprim në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë, të Paluajtshme, të Fituara

me Atin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, përcaktuar në tabelën e mësipërme emërtuar “Personat përgjegjës për kërkesat pa përgjigje ndaj ZVRPP nga KVVTP dhe për përgjigje të vonuara 2012-2015”.

c. Mungesa e dokumentacionit fizik në arkiv për **235 kërkesave**, lënia në përdorim të specialistëve të zonave, mos lidhja e kërkesës në dosje të veçanta me gjithë dokumentacionin shoqërues deri në përfundimin e Vendimmarrjes, dhe mos dorëzimi në arkiv në periudhën 5 vjet, vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për Arkivat”, dhe për shkeljen e afatit 1 muajor të KPA, me Urdhrat e regjistruarit, *Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për Punën në ZVRPP”, të ndryshuar, dhe me Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në ZRPP”,* përcaktuar në tabelën emërtuar “Personat përgjegjës për kërkesat pa përgjigje ndaj KVVTP dhe për përgjigje të vonuara 2012-2015.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, të inventarizohen dhe çelen dosjet përkatëse për **235 kërkesa** për verifikim, konfirmim të Titujve të Pronësisë së Tokës bujqësore të ZVRPP drejtuar KVVTP, duke kthyer shkresat origjinale në arkivë, dhe për **197 kërkesa** pa përgjigje, dërguar për shqyrtim në KVVTP, të rishqyrtohen AMTP-të nga ZVRPP Tiranë dhe për ato AMTP që dalin detyrim dhe kompetencë e ZVRPP pasi të identifikohen pasuritë, të zbatohen procedurat ligjore të regjistrimit me synim kryerjen e shërbimit të paguar dhe të pa marre të qytetarëve, pasqyruar sipas tabelave “*Kërkesa të ZVRPP Tiranë drejtuar KVVTP për vitet 2012-6/mujori I-rë 2015*”, “Personat përgjegjës për kërkesat pa përgjigje ndaj ZVRPP nga KVVTP dhe për përgjigje të vonuara 2012-2015”.

3. Gjetje: ZVRPP Tiranë nuk ka një evidentim, ndjekje dhe informim të brendshëm të stafit të ZVRPP Tiranë, për pronat e regjistruara me mbivendosje, të cilat nga auditimi mundëm me afërsi të evidentojmë raste me disa pasuri të llojit tokë troje, objekte, të regjistruara me mbivendosje, kryesisht ndaj pronës shtetërore dhe ndaj pronave private, duke evidentuar një performancë të dobët menaxhimi, mungesë transparence, trajtim i pabarabartë i palëve, si pasojë në disa raste dhe krijimin e regjistrimeve me mbivendosje nga vetë kjo zyrë, në kundërshtim me ligjin nr.7843 datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjin nr. 33/12, datë 21.03.2012 dhe me aktet tjera nënligjore .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të bëjë identifikimin dhe evidentimin e pasurive të regjistruara me mbivendosje dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, në zbatim të përcaktimeve të pikës 3, neni 37, neni 59 dhe pika 1 e nenit 60 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe të bëjë njoftimin e palëve, Zyrën e Avokatit të Shtetit (ZAVSH), kur rasti lidhet me pronë shtetërore; për ndjekjen e procedurave ligjore **për zgjidhjen e mbivendosjes**, lidhur me pasuritë rezultuar me mbivendosje përkatësisht për;

a. për mbivendosjen prej **në 39 m²**, pjesë e pasurisë nr. 5/251, v.16, f.17, zk.8260 me sipërfaqe 78 m²truall në pronësi të trashëgimtarëve “Tartari” dhe gjithashtu pjesë e pasurisë nr.5/266, v.20, f.77, zk.8260 me sipërfaqe 371 m² e llojit truall, në pronësi të pronarëve “Vila”, mbi të cilën është regjistruar 3 vjet më vonë pallat.

4. Gjetje: Në ZVRPP Tiranë prej vitesh, nuk janë ndjekur hapat për instalimin e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm në sistemin e administrimit të dokumentacionit,, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pasi:

1. Nuk ka një rregullore të brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Tiranë, të miratuar nga Kryeregjistruesi për periudhën e mëparshme dhe për vitet 2012-2015 të bazuar ne organikat dhe organigramat dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013, të Kryeministrit” “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, dhe Urdhrave nr. 58, datë 23.04.2009, nr. 33, datë 02.04.2014 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

Për pasojë nuk ka një përcaktim, përshkrim të kryerjes së detyrave, lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësive të secilit specialist sipas 10 sektoreve, Regjistruesit, 2 zv.Regjistruesve dhe 3 juristëve, lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi, sidomos lidhur me administrimin e dokumentacionit me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve, për mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësive të zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj., Pra mungon **Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB)**, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Gjithashtu, mungojnë dhe nuk janë përcaktuar e shkruar, kushtet e pranimit, testimi fillestar dhe në vlerësim të aftësive profesionale, trajnimit dhe aftësimit të marrjes në punë të punonjësve në këtë ZVRPP.

Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, përveç se është një rregullore tekniko ligjore e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhej përmbledhur e bërë e plotë, duhet përshtatur me ligjin aktual.Kjo nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit dhe zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Rekomandim: ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë, të ndjekin hapat e duhura ligjore, për vendosjen dhe instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, lidhur me Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) **dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë dokumentet ligjorë:**

a. Rregulloren e brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Tiranë, të miratuar nga Kryeregjistruesi të bazuar ne organikat dhe organigramat dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr.33, datë 2.4.2013, të Kryeministrit”; ku të përfshijnë(shkruhen) kushtet e pranimit, testimi fillestar dhe në vazhdim të aftësive profesionale, trajnimit dhe aftësimit të marrjes në punë të punonjësve në këtë ZVRPP, statusi i të punësuarve si dhe përcaktim të kryerjes së detyrave, ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësive të secilit specialist sipas 10 sektorëve, Regjistruesit, 2 zv.Regjistruesve dhe 3 juristëve, detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi administrimin e dokumentacionit, si dhe të përcaktohen e vendosen SMKB (Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm) nëpërmjet vënies nën administrim dhe administrimit të dokumentacionit tërësor dhe të praktikave në proces (mos lënia e tyre për kohë të gjatë tek specialistët).

b. Të hartojë Rregulloren Tekniko-Ligjore të përshtatur e përditësuar me ligjin e ri dhe bazën tjetër ligjore të re të ndryshuar, pasi Rregullorja tekniko-ligjore aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, përveç se është një rregullore tekniko ligjore e tejkaluuar në kohë dhe me ndryshime të pjesshme, që nuk përshtaten me ligjin aktual.

5. Gjetje: **a.** Nivel i ulët i performancës së punës së ZVRPP Tiranë i shprehur në;

1. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 5 vitesh deri në vitet 2015, arrijnë në rreth mbi **15 533 (pa përfshire v.2015)**, me të ardhura të përfituara nga ZVRPP në vlerën **55,269 mijë lekë**, pa dhënë shërbimin e faturuar në sportel. Kjo ka sjellë mungesë transparence të punës së ZVRPP Tiranë ndaj publikut, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, sipas tabelës nr.3 “*Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces dhe të ardhurat e përfituara pa shërbim prej para Vitet 2010 dhe 2011- 6/mujori 2015*”, në kundërshtim e ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”,

2. Mungesën e një performace, në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës, lidhur me shërbimin ndaj publikut dhe forcimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin”, lidhur me mungesën e rregullores së brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Tiranë, me mungesën e rishkrimit dhe aktualizimit Rregullores aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.Kjo rregullore është e pa përshtatur me kërkesat e ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, dhe me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

3. Për pasojë nuk ka një përcaktim të qartë të detyrave e përgjegjësive për përgatitjen e evidencave informative në tërësi, shërbimit të IT, trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve lidhur me mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit, lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësive së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave, pra mungon instalimi i Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej 5 vitesh deri ne vitet 2015, të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, të kryejë kontrollin ligjor të rregullshmërisë së praktikave të mbetura në proces dhe të evadohen **15 533 aplikimet** e praktikave,që aktualisht janë në proces, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara, pa dhënë shërbimin e faturuar në vlerën **55,269 mijë lekë**, e cila ka sjellë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Tiranë ndaj publikut. Të inventarizohen, administrohen në arkiv dokumentacioni përkatës i praktikave, si dhe të evidentohen e inventarizohen praktikat në proces të vitit 2015, sipas tabelës analitike nr.2 “*Përmbledhëse e praktikave ne proces te pa përfunduara sipas viteve*” dhe tabelës nr.3 “*Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces dhe të ardhurat e përfituara pa shërbim prej para Vitet 2010dhe 2011- 6/mujori 2015*”.

6- Gjetje: Konstatuam se veprimet në kartelën e pasurisë nr. 3/22, v.13, fq.51, zk. 8210, nuk ndjekin rrjedhën kronologjike të pasqyrimin të veprimeve nga pasuria mëmë me sipërfaqe 6415 m² privatizuar sipas referencës nr. 2799, duke mos paraqitur veprimet e rrjedhura lidhur me pasurinë nr. 3/113 ND, v.16, fq.84, e cila duhej të ishte bijë e pasurisë së mësipërme. Gjithashtu nuk evidentohen as në harta dhe as në kartelet diferenca prej 6415 m² deri tek zbritja tek sipërfaqja 5920 m², pasqyruar me referencën nr. 4897, datë 20.09.2009. Gjithashtu, nuk ka asnjë bilanc të pasurive kufitare rreth pasurisë mëmë apo relacion, si dhe ka mospërputhje ndërmjet planimetrisë së privatizimit të datës 08.09.1994, dhe hartës treguese përfundimtare sipas referencës nr. 8580 .

Rekomandim: Të bëhet rilevimi i pasurive për rreth pasurisë mëmë nr. 3/22, v.13, fq.51, zk. 8210, duke identifikuar pasuritë, si dhe të bëhen shënimet në kartelën e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Rregulloren Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 si dhe Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Brenda muajit Shkurt 2016

7- Gjetje: Dhënia e lejes së legalizimit nr. 103911, datë 06.08.2013, për 12 kate banimi dhe 4 kate aktivitet për objektin Qendra Tregtare Ring Center pasuria nr. 3/22, v.13, fq.51, zk. 8210, vjen në kundërshtim me kondicionet e lejes së ndërtimit Nr. 91, datë 07.06.2008 si dhe ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” Neni 2-Fusha e Zbatimit, pika 4 dhe me planin urbanistik të qytetit të Tiranës i miratuar me Vendimin nr. 1, datë 15.02.2013 të KKT-së .

Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, për vlerësimin e ligjshmërisë së dokumentacionit të regjistrimit të legalizimit nr. 103911, datë 06.08.2013, për 12 kate banimi dhe 4 kate aktivitet për objektin Qendra Tregtare Ring Center pasuria nr. 3/22, v.13, fq.51, zk. 8210, e cila është në kundërshtim me kondicionet e lejes së ndërtimit Nr. 91, datë 07.06.2008 si dhe ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” Neni 2-Fusha e Zbatimit, pika 4 dhe me planin urbanistik të qytetit të Tiranës i miratuar me Vendimin nr. 1, datë 15.02.2013 të KKT-së, duke bërë sistemimet e nevojshme .

8- Gjetje: Në 4 raste në KKP-të, nuk janë regjistruar në rubrikën “Përshkrimi i veçantë” dhe kornizën “Për pjesën e përbashkët” për pallatin në tërësi dhe për çdo aksesor të tij (apartament, shesh pushimi, shkallë, ashensor, kabinë, depozita uji, sistem ngrohje etj). Pra nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj investitorëve përkatësisht në sipërfaqe totale prej 3900.73 m², **me një dëm ekonomik në vlerën 3,900,730 lekë** (sip. 3754.73 m² x 1000 lekë/m²), përkatësisht si më poshtë:

- Pasuria pallat 3/348, vol. 35, fq.169, zk. 8380, në pronësi të “N.... 10” Sh.p.k, sipërfaqja **435.8 m²**.(sip.435,8 m² x 1000 lekë/m²= 435,800 lekë).

- Pasuria pallat 315/581, vol. 93, fq. 46, zk. 3866 në pronësi të “A...Nd...” Sh.p.k, sipërfaqja **575.32 m²**, në vlerën prej **575,320 lekë** (575.32m²x1000 lekë/m²/ndërtim)

- Pasuria pallat 216/194, vol. 66, fq. 210, dhe vol 67, fq. 146, zk. 3866 në pronësi të shoqërisë “I.” Sh.p.k., me sipërfaqe totale **2135.51 m²** (sip.2135.51 m² x1000 lekë/m²=2,135,510 lekë).

- Pasuria pallat 216/194, vol. 66, fq. 210, vol 67, fq. 146, zk. 8380, në pronësi të shoqërisë “M...Konstruksion” Sh.p.k, me sipërfaqe totale **754.10 m²** (sip. 754.10 m² x 1000 lekë/m²=754,100 lekë).

Këto veprime e mosveprime, janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 50, “**Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa**”, pika 2, ligjin nr. 9632, datë 30.10.1996 “Për Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar neni 28, pika 2. Mosveprime qëndrojnë në faktin se nuk i janë ndalur firmës ndërtuese që në regjistrim, pasi apartamentet dhe njësitë e shitura qytetarëve përfshijnë në çmim dhe vlerën e këtyre ambienteve të përbashkëta .

Rekomandim: ZVRPP Tiranë, të marrë masa për të plotësuar, kartelat e pasurive të paluajtshme, seksioni për sipërfaqet e përbashkëta sipas përqindjes së pjesëmarrjes në përputhje me Udhëzimin Metodik për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 si dhe ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”. Gjithashtu në çdo rast për pasuritë pallat për njësitë e katit nëntokë si kabina elektrike, ambjentet si dhoma e pastrueseve, ambjente shërbimi për hidraulikët, depozita e ujit dhe sistemi i pompave dhe ambjenti teknik për ashensorët, të hapen kartelat përkatëse të pasurisë.

9- Gjetje: Nga auditimi i praktikës së pasurisë nr. 3/348, vol. 35, fq.169, zk. 8380, në pronësi të “**Ndërtuesi 10**” Sh.p.k, regjistruar me Ref. 12703, është konstatuar se nuk ndodhet në dosje Vendim i Këshillit të Ministrave, mbi bazën e të cilit është miratuar legalizimi i sipërfaqes truall dhe sipërfaqes së ndërtimit .

Rekomadim: Nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të nxirret urdhër kufizimi për pasurinë nr. 3/348, vol. 35, fq.169, zk. 8380, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 59, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor.

10. Gjetje: Në auditimin e praktikave për regjistrimin e objekteve me leje ndërtimi mbi troje publike dhe private, në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, janë konstatuar probleme në mbajtjen dhe plotësimin e kartelave të pasurisë si dhe inventarizimin e praktikave dhe referencave, si më poshtë:

- Në vol. 18, zk. 3866, ndërmjet KPP faqe 167 dhe 168, është lënë bosh një fletë karte e firmosur dhe e vulosur.

- KPP për pasurinë nr. 315/149, vol.20, fq. 115, zk. 3866, është mbyllur por nuk është vulosur dhe firmosur nga regjistruesi.

- Për çdo KPP të hapura për pasurinë pallat 315/581, vol.93, fq.46, zk. 3866, shoqëria “A...s N... Sh.p.k, gjithsej 92 pasuri, të regjistruara nga faqe 47 deri në faqe 137 të këtij pallati, janë të pavulosura dhe firmosura nga regjistruesi, pa datë përfundimtare dhe nuk është plotësuar orgjina se nga vjen pasuria.

- Në kartelën e pasurisë 216/194-G6, vol. 66, fq. 216, zk. 3866, Garazh, regjistruar sipas referencës nr. 13920, nuk është shënuar orgjina se nga vjen pasuria, kartela është pa firmë dhe pa vulë.

- Në kartelat e pasurive të hapura për 11 njësi, të rrjedhura nga pasuria mëmë nr. 6/30, vol. 21, fq. 173, në pronësi të Arben Nuriu, regjistruar me Ref. 12643, u konstatua se në asnjë prej tyre nuk është shënuar se nga vinë pasuritë, pra orgjina e tyre. Nuk është bërë mbyllja e kartelës mëmë për pasurinë e llojit truall me nr. 6/30, vol. 21, fq. 173, si nuk është firmosur e vulosur nga regjistruesi.

- Inventari i dosjes për Referencën nr. 12457, sipas të cilës është regjistruar pasuria 216/194, vol. 66, fq. 210, vol 67, fq. 146, në pronësi të “Iliad “ Sh.p.k, është i painventarizuar dhe vulosur.

- Referencat nr. 1903, datë 13.11.2001 dhe nr. 1980, datë 26.12.2001, dhe nuk janë inventarizuar dhe nuk janë plotësuar me numër rendor progresiv, në kundërshtim me ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Per arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP” .

Rekomadimi:

a- Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masat e nevojshme, në mënyrë që kartelat e pasurive të paluajtshme të nënshkruhen nga punonjësi që kryen veprimet në kartelë, të plotësohet data përfundimtare, origjina se nga vjen pasuria dhe ku shkon, të mbyllen kartelat, si dhe të mos kryhen më veprime në kartela të pasurive të paluajtshme, me urdhër të panënshkruar dhe të pavulosur, nga Regjistruesi në përputhje me Udhëzimin Metodik për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 si dhe ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

b- Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të nxjerrë urdhër të brendshëm për zbatim, që në momentin e kryerjes së inventarizimit të dokumentacionit që ndodhet në referencë, të vendoset detyrimisht numri i çdo dokumenti sipas radhës, si dhe referencat të firmosen nga specialistët përkatës të cilët e kanë punuar, në zbatim të të kërkesave të ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Per arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP.”

11- Gjetje: Në auditimi i praktikës së pasurisë së shtetasit N,A, Yzberisht, nr. 315/1/4, vol. 9, fq.191, zk. 3866, rezultoi se nxjerrja e urdhrit nr. 4088, datë 22.10.2013, me referencën nr. 13503, datë 22.10.2013, të ish-regjistruesit F.H, për lirimin nga kufizimi i parcelës nr. 315, vendosur sipas urdhrit nr. 474, datë 23.03.2011, me referencën nr. 8084, datë 24.03.2011, nuk është i rregullt dhe i argumentuar pasi në referencën nr. 13503 mungojnë deklaratat noteriale për pasurinë 315/148, vol.20, fq.114, në pronësi të bashkëpronarëve Ago, për pasurinë 315/159, vol. 20, fq. 247, në pronësi të M. A dhe për pasuritë nr. 315/160, vol. 20, fq. 248 në pronësi të F.M. Heqja e kufizimit mbi këto pasuri vjen në kundërshtim me urdhrin e mësipërm nr. 474, datë 23.03.2011, pasi nuk janë paraqitur deklaratat noteriale të gjithë pronarëve mbi pasuritë e të cilëve është vendosur kufizimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 33/2012, datë 29.04.2012 për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, neni 59, “Regjistrimi i Kufizimeve” dhe Rregulloren Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 dhe urdhrin nr. 474, datë 23.03.2011 për vendosje kufizimi në parcelën nr. 315 .

Rekomadim: Nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të nxirret urdhër kufizimi për pasuritë e ndodhura parcelën nr. 315 zona kadastrale 3866, Yzberisht, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar, sipas urdhrit për vendosjen e kufizimit nr. 474, datë 23.03.2011, të ish-Regjistruesit.

12. Gjetje: Inventari i dosjeve të referencave 7318, nr pasurisë 11/59, vol. 27, fq.151, Ref. 7319, nr pasurisë 11/57, vol. 27, fq.149, Ref. 7011, 11/44, vol. 15, fq. 228 dhe nr. 11/45, vol. 15, fq. 229, Ref. 1396, nuk ishin firmosur nga specialistët përkatës, ndërsa Ref. 1396 nuk ishte bërë inventarizimi në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP.

Rekomandim: ZVRPP Tiranë të marrë masa që në administrimin e dokumenteve dhe inventarëve të dosjeve të pasurive, të merren masa për zbatimin e plotë të kërkesave të përcaktuara me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren e ZQRPP nr.184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme” të ndryshuar, Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”, si dhe të bëhet inventarizimi i Ref. 1396, zk. 2679.

13. Gjetje: Në auditimin e praktikës së pasurisë nr. 11/1, vol. 3, fq. 240, zk. 2679, “truall” fshati Mëzez, në pronësi të Myzafer Murataj rezultoi se **hipoteka 1851**, zk. 2679, shoqëruar me kontratën e shitjes nr. 8678/5605, datë 18.05.1994 dhe librit nr. 7101-7200, viti 1996, **hipoteka 7147**, shoqëruar me kontratën e dhurimit nr. 16544/3217, datë 10.10.1996 rezultojnë të tërhequra nga arshiva nga ish-Specialisti hartograf z. Z.K dhe gjatë periudhës së kontrollit nuk u gjetën në arkiv, kjo u konfirmuar dhe nga specialistja e arkivës znj. M.P. Gjithashtu dhe **referenca me nr. 1395** nuk ndodhej në zyrën e arshivës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP.”

Rekomandim: ZVRPP Tiranë, në administrimin e dokumenteve dhe inventarëve të dosjeve të pasurive të marrë masa për zbatimin e plotë të kërkesave të përcaktuara me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren e ZQRPP nr.184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme” të ndryshuar, Rregulloren nr. 207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP.”

14. Gjetje: Në auditimi i praktikës së pasurisë nr. 11/1, vol. 3, fq. 240, zk. 2679, “truall” fshati Mëzez, në pronësi të M.M rezultoi se nxjerrja e urdhrave të brëndshëm nr. 1670, datë 23.05.2012 sipas Ref. 7011 për vendosje kufizimi dhe nr. 3418, datë 13.08.2012 sipas Ref. 7221, **për heqje kufizimi**, të regjistruarit F.H, për pasurinë nr. 11/45, ka mangësi në formë dhe në përmbajtje, pasi nuk është shoqëruar me një relacion të punonjësve mbi mangësitë në dokumentacion, rrjedhimisht urdhri duhet të dalë me emërtimin për kufizimin e pasurisë, si dhe duhet të përmendë referencën e saktë ligjore, veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 59, dhe Rregulloren e ZQRPP nr.184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme” të ndryshuar.

Rekomandim: ZVRPP Tiranë të marrë masa që në çdo rast të nxjerrjes së urdhrit të kufizimit mbi pasuritë të respektohen kërkesat ligjore në përputhje me ligjin Nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 59, duke përmendur referencën e saktë ligjore, me emërtimin urdhër kufizimi, si dhe të shoqërohet me dokumentacionin përkatës si relacion i specialistëve.

15. Gjetje: Si rezultat i mosveprimeve të ish-regjistruarit F.H, edhe pas ardhjes së rekomandimit të lënë nga KLSH në vitin 2008, me shkresën nr. 732/25, datë 04.07.2008, **për nxjerrjen e urdhrit të pezullimit dhe kufizimit** për pasurinë “Pikë Karburanti”, pjesë e pasurisë nr. 11/1, vol. 3, fq. 240, zk. 2679, fshati Mëzez, e cila është pa leje ndërtimi si dhe është spostuar sheshi i ndërtimit, **është lejuar vazhdimi i pasojës së përfitimit të padrejtë të shumës prej 19,704,189 lekë**, ku në bazë të VKM nr. 867, date 12.12.2007, shtetas A. M, është shpronësuar për interes publik për pikën e karburantit që preket nga ndërtimi i rrugës paralele Tiranë-Vorë (krahu i majtë), duke marrë si dëm shpërblim shumë prej 19.704.189 lekë. Mosveprimet e ish-Regjistruarit F.H, janë në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 59 “Regjistrimi i

Kufizimit” dhe Rregulloren Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000, Kreu II, pika 6.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 59, deri në marrjen e konfirmimit për kthimin e shumës **prej 19,704,189 lekë**, përfituar padrejtësisht me shpronësim sipas VKM nr. 867, datë 12.12.2007 nga shtetase A.M, për pasuritë e ndodhura në zonën kadastrale 2679 dhe konkretisht:

- nr. 11/57 vol. 27, fq. 149, zk. 2679, sip.1185 m²,

- nr. 11/59 vol. 27, fq.151, zk. 2679, me sipërfaqe 1185m².

16. Gjetje: Kartelat e Pasurive të Paluajtshme (KPP) nr. 11/44, vol. 15, fq. 228, dhe nr. 11/45, vol. 15, fq. 229 janë mbyllur pa vulën dhe firmën e regjistruarit në kundërshtim me Rregulloren Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 si dhe Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme” .

Rekomandim. Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masat për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme, me nënshkrimet e duhura nga punonjësit që kryejn veprimet në kartelë, të plotësohen datat përfundimtare, të mbyllen kartelat, të përcaktohen në cilin volum dhe faqe vijojnë pasuritë e ndara, si dhe të mos kryhen më veprime në kartela të pasurive të paluajtshme, me urdhër të panëshkruar dhe të pavulosur nga Regjistruesi, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

17. Gjetje: Në kontratën nr. 1350/1802, datë 09.9.2013 për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Tregtare dhe shoqërisë “*Ch... F...*” sh.a., për kategorinë e tokës bujqësore me sipërfaqe prej 39,52 ha, sipas kontratës rezulton se është regjistruar në parcelën nr. 82, sipërfaqja prej 900 m² “tokë pa fryt”, në volum 2 faqe 132 zona kadastrale 1167 dhe në parcelën nr. 74 sipërfaqja prej 3000 m² “Troje”, në volum 7 faqe 78 zona kadastrale 1167. Nga ZVRPP Tiranë, është kryer regjistrimi i dy parcelave, me zë kadastral të ndryshëm sipas kontratës së qirasë dhe faktit, pra sipas librit të Ngastrave dhe kartelave të pasurive të paluajtshme, kur konstatohet se në parcelën prej 3000 m² truall, shtetit i është krijuar një efekt financiar në vlerën prej 7,200,000 lekë, **(3000 m² x 100 lekë/m² në muaj x 24 muaj (nga regjistrimi i kontratës deri më sot), kur kjo sipërfaqe është marrë si tokë bujqësore kundrejt tarifës prej 11,111 lekë për ha/vit, ndërkohë që duhet të merrej për bazë VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu III, pika c).** Veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar .

a. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 59, për pasurinë nr. 74, me sipërfaqe prej 3000 m², truall, volum 7 faqe 78 zona kadastrale 1167, **ky kufizim të zgjasë deri në ndryshimin e kontratës së qirasë nr. 1350/1802, datë 09.9.2013.**

b. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe t’i bëhet me dije Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, mbi konstatimin nga

auditimi i KLSH-së për parregullsitë sipas kontratës nr. 1350/1802, datë 09.9.2013 dhe parregullsive në regjistrim **me pasoja financiare në vlerën 7,200,000 lekë.**

18. Gjetje: Në **6 raste**, në praktikën e pasurisë me mbivendosje për bashkëpronarët Alla, zonë kadastrale 2679, nxjerrja e urdhrave përkatësisht urdhrit nr. 226, datë 11.09.2000, Ref. 826 për ndarje pasurie, urdhrit nr. 236, datë 19.09.2000, me Ref. 0848, për ndarje pasurie, urdhrit nr. 209, datë 17.08.2000, Ref. 0797, për ndarje pasurie, urdhrit nr. 141, datë 01.07.2002 “Për bashkim të pasurive shtetërore” me Ref. 01718, urdhrit nr. 141, datë 01.07.2002, për ndarje pasurie të ish-Regjistruesit V.P, dhe urdhrit pa numër, datë 25.08.2005, për ndarjen e pasurisë, me Ref. 4324 të ish-regjistrueses M.B, është e parregullt, ***pasi asnjë prej urdhrave më sipër nuk argumenton shkakun, nevojën e detyrimit të kryerjes së veprimit të ndarjes ose bashkimit, nuk përmend AMTP e kërkuessit***, veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe Rregulloren e ZQRPP nr.184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme” të ndryshuar .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, në çdo rast të nxjerrjes së urdhrit për ndarje apo bashkim pasurie, të kërkojë dhe zbatojë kërkesat e ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe Rregulloren e ZQRPP nr.184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme” të ndryshuar, duke e shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që argumenton veprimin.

19. Gjetje: Pasuria 123/1 vol. 11, fq. 244 zonë kadastrale 2679, është mbyllur dhe ka kaluar me Ref. 0848, në pasuritë 123/3, vol. 12, fq.8 me sip. 3000 m² e llojit arë, 123/4 vol. 12, fq.9 me sip. 11475 m², e llojit arë dhe 123/5, vol. 12, fq.10 me sip. 6100 m², e llojit arë, në bazë të urdhrit nr. 236, datë 19.09.2000 për ndarje pasurie të Ish-regjistruesit Vladimir Pëllumbi. **Ky urdhër përmban pasaktësi në përcaktimin e sipërfaqeve të ndara**, pasi $6100 + 3000 + 11475 = 20575$ m², pra nuk përputhet me sipërfaqen e pasurisë së orgjinës 123/1 vol. 11, fq. 244, me 20543 m², më shumë 32 m², çka ka sjell dhe regjistrimin e gabuar të sipërfaqeve të pasurive të rrjedhura, konkretisht pasurisë 123/4 vol. 12, fq.9 me sip. 11475 m², ndërkohë që sipërfaqja e kësaj pasuri duhet të ishte 11443 m², në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe të bëjë korigjimi në kartelën e pasurisë 123/4 vol. 12, fq.9, duke vendosur sipërfaqen e saktë, bazuar në Neni 63 “Korigjimi nga regjistruesi” i ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzimin metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

20- Gjetje: Nga auditimi i praktikave referente, kartelave të regjistrimit të Pasurive (KP) dhe dokumentacionit bashkëlidhur referencave është konstatuar mbivendosje prone në ZK 2679 Mëzez, përkatësisht **pasuria 124/27**, volum 26 faqe 117, sipërfaqe 3375 m², lloji i pasurisë truall, në emër të Sh.A dhe Dh.A, sipas planit të rilevimit të paraqitur, **krijon mbivendosje me pasuritë:**

a)- Pasuria 124/5, zonë kadastrale 2679, volum 11 faqe 209, në pronësi të Y.M, me sipërfaqe totale 1050m².

b)- Pasuria 124/2, zonë kadastrale 2679, volum 11 faqe 155, në pronësi të A.G, me sipërfaqe totale 7000 m².

c)- Pasuria 124/32, zonë kadastrale 2679, volum 11 faqe 155, në pronësi të K.M, me sipërfaqe totale 6114 m2.

-Pasuria 124/28, volum 26 faqe 118, sipërfaqe 3375 m2, lloji i pasurisë truall, në emër të B.A, K.A, E.A, krijon mbivendosje me pasuritë:

a)- Pasuria 124/32, zonë kadastrale 2679,volum 11 faqe 155, në pronësi të K.M, me sipërfaqe totale 6114 m2.

b)- Pasuria 124/30, zonë kadastrale 2679,volum 28 faqe 149, në pronësi të Sh.A, me sipërfaqe totale 1621 m2.

c)- Pasuria 512, e paidentifikuar, evidentohet vetëm në HTR dhe nuk ka informacion në printimin e tretë dhe në programin I.P.S.

d)-Pasuria 123/18, zonë kadastrale 2679,volum 19 faqe 196, në pronësi të “E..+A”sh.p.k, me sipërfaqe totale 5000 m2.

- Konstatuam se nuk janë zbatuar procedurat për trajtimin e rastit të mbivendosjes për pasuritë më sipër si mbajtja e një akti apo relacioni për konstatimin e mbivendosjes, **njoftimin e palëve dhe nxjerrjen e urdhrin të kufizimit mbi pasuritë të cilat krijojnë mbivendosje**, nuk është hartuar një relacion apo akt-verifikim në lidhje me problematikën e hasur për zbatimin e Vendimit e Gjykatës Nr. 2133 datë 05.07.1999. Mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin Nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme”, Urdhërin nr. 364, datë 27/04/2012 “Për miratimin e propozimeve të këshillit drejtues tekniko-ligjor” si dhe Vendimin e Gjykatës Nr. 2133 datë 05.07.1999 .

- **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa për të zbatuar procedura, për trajtimin e rastit të mbivendosjes, si mbajtja e një akti apo relacioni për konstatimin e mbivendosjes, **njoftimin e palëve dhe nxjerrjen e urdhrin të kufizimit mbi pasuritë të cilat krijojnë mbivendosje**, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme “, Urdhërin nr. 364, datë 27/04/2012 “Për miratimin e propozimeve të këshillit drejtues tekniko-ligjor” si dhe Vendimin e Gjykatës Nr. 2133 datë 05.07.1999., **deri në zgjidhjen e problemit të mbivendosjes për pasuritë**, si më poshtë:

- pasuria 124/27, zonë kadastrale 2679, volum 26 faqe 117,

- pasuria 124/5, zonë kadastrale 2679, volum 11 faqe 209,

- pasuria 124/2, zonë kadastrale 2679, volum 11 faqe 155,

- pasuria 124/32, zonë kadastrale 2679, volum 11 faqe 155,

- pasuria 124/28, zonë kadastrale 2679, volum 26 faqe 118,

- pasuria 124/30, zonë kadastrale 2679,volum 28 faqe 149,

- pasuria 512, zonë kadastrale 2679, e paidentifikuar, evidentohet vetëm në HTR dhe nuk ka informacion në printimin e tretë dhe në programin I.P.S.

- pasuria 123/18, zonë kadastrale 2679, volum 19 faqe 196

21- Gejtje: Në verifikimin e Ref. 6759, ndarje pasurie, për pasurinë 124/16, vol. 18, fq. 23, me sip.7380m2, në sistemin I.P.S, u konstatua se brenda të njëjtës referencë janë hedhur dy praktika të ndryshme, të cilat nuk kanë lidhje me njëra tjetrën, njëra për pasuritë nr. 124/27, vol. 26, fq. 117, nr. 124/28, vol.26, fq. 118 zk. 2679 dhe njëra për pasuritë nr. 37/42+1-4,

vol.23, fq.89 me sip 68.1 m2, në pronësi të Gj.N dhe S.N dhe nr. 37/42-G9, vol, 26 fq.45, me sip. 53.1 m2, zk. 2679, në pronësi të M.R dhe J.R

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP-Tiranë të marrë masa për ndarjen në sistem të dy referencave, si dhe numërtimi i tyre i ri për secilën nga pasuritë nr. 124/27, vol. 26, fq. 117, nr. 124/28, vol.26, fq. 118 zk. 2679 dhe njëra për pasuritë nr. 37/42+1-4, vol.23, fq.89 me sip 68.1 m2 dhe nr. 37/42-G9, vol, 26 fq.45, me sip. 53.1 m2, zk. 2679.

22- Gjetje: ZVRPP Tiranë, për zonën 1, nuk ka ndjekur procedurat për hartimin e dokumentacionit për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt, si dhe nuk ka kryer evidentimin e raportimin e ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015, lidhur me 37 vendimet marrë nga Gjykata e Shkallës Parë Administrative Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë për të cilat në 8 raste ZVRPP ka qenë palë kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve të cilat i përkasin Zonës 1, të cilat i janë dërguar në ZVRPP Tiranë për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme dhe regjistrim “shtet” të **30 AMTP-ve me mbi 45 pasuri** me sipërfaqe totale **prej 647660 m²** nga e cila: shlyerje të detyrimit ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej **31 255 m²** në vlerën **22,604,135 lekë**, kthim e regjistrim në pronësi “shtet” të sipërfaqes prej **332 881 m² tokë bujqësore të llojit “arë”, “vresht”, “ullishtë” “pemëtore”**.

- Në asnjë rast nuk ishte vendosur masë kufizimi mbi pasuritë, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit.

-nuk është regjistruar “Shtet” asnjë metër kundrejt **332881 m²**,

-nuk janë vendosur barrë mbi pasuritë e tjetërsuara në **9 raste për 31,255 m²**, me vlerën prej **22,604,135 lekë** (deri në përfundimin e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët me objekt vlefshmërinë e titujve të pronësisë) që ka sjellë si pasojë mos arkëtim dhe dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, nga të cilat:

në 5 raste në sipërfaqen prej 18,900 m²(është marrë Vendim Gjykatë për ti kthyer “shtet”, e për pasojë edhe kthimin e shumës koresponduese prej mbi **8,309,820 lekë përfituar padrejtësisht sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes;**

në 2 raste ka vendim të KVVTP-së për sipërfaqen 2400 m2 dhe kthimin e shumës koresponduese 1,120,200 lekë, në total për 7 rastet më sipër vlera 9,430,020 lekë; **ndërsa në 2 raste** me Vendim Gjykatë është rrëzuar kërkesa padia për sipërfaqet 9955 m2 me vlerë koresponduese 13,174,135 lekë. Mosveprime dhe veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me vetë Vendimet e Gjykatave, dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, të ndryshuar, që ka sjellë si pasojë lënien në gjendje juridike me pronësi të mbajtësit të paligjshëm dhe mos kalimin e titujve të pronësisë “Shtet”, pasqyruar në tabelën nr. “**ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2012-2015 Zona nr. 1**”,

Nga auditimi i vendimeve të KVVTP Prefekti Qarkut Tiranë dhe Vendimeve të Gjykatave e Shkallës Parë Administrative Tirane, me palë paditëse Prefekti Qarkut Tiranë, të paditur mbajtësit përkatës të titujve të pronësisë me AMTP, përfaqësues të familjeve bujqësore dhe palë e tretë ZVRPP Tiranë, rezulton se gjithnjë ka qenë në mungesë, duke mos marrë pjesë në gjykim.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të identifikojë pasuritë objekt zona 1, të ndjekë procedurat për hartimin e dokumentacionit, regjistrimin, evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 lidhur me **37 vendimet** e Gjykatës së Shkallës Parë Administrative Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë për të cilat në **8 raste** ZVRPP ka qenë pale kërkuese, **ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP**, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve që i përkasin Zonës 1, ZVRPP Tiranë të dërguara për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesëshme dhe regjistrim “shtet” të **30 AMTP-ve** me **mbi 45 pasuri** me sipërfaqe totale **prej 647 660 m²** për të cilat:

- a. -**Të kërkojë kufizim, kthim e regjistrim në pronësi ”shtet”** të sipërfaqes prej **332 881 m²** tokë bujqësore të llojit “arë”, ”vresht”, ”ullishtë” “pemëtore”.
- b. **Të vendosë masat kufizuese** për pasuritë ku nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen 332,881 m², gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit,
- c. Të regjistrojë “Shtet” pasuritë (ku nuk është regjistruar “Shtet” asnjë metër) që i përkasin sipërfaqes **332 881 m²**,
- d. **Të vendoset kufizimi mbi dy pasuritë e tjetërsuara** me sipërfaqe **9955 m²**, me vlerën prej **13,174,135 lekë** (në të dyja rastet ka përfunduar procesi gjyqësor vetëm në shkallë të parë me rrëzimin e padisë, ndërkohë që nga ZVRPP deri në marrjen e vendimit nga gjykata nuk është ndërmarrë asnjë veprim për kufizimin mbi këto pasuri), deri në përfundimin e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët.

23- Gjetje: Në një rast për pasurinë nr. 193/20, vol. 26, fq. 197, me sip. 1000 m², zk. 3866, Yzberish, e llojit arë në pronësi të H.Zh, e regjistruar me Ref. 4829 në bazë të AMTP nr. 292, viti 1996, me vendimin e KVVTP-së nr. 1, datë 04.09.2012, është vendosur shfuqizimi i plotë i AMTP-së dhe kthimi i sipërfaqes prej 1000 m² në pronësi shtet. Nga verifikimi i KPP për këtë pasuri, rezultoi se nuk është plotësuar rubrika për origjinën nga vjen prona, në rubrikën përshkimi i veçantë, ndodhet shënimi me laps “shpronësohet 1000 m², me VKM nr. 61, datë 12.02.2014”, pa firmën e specialistit që ka bërë shënimin, ndërsa në seksionin D, nuk ka asnjë shënim për kufizimin e pasurisë. Si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të mësipërme jo vetëm, që nuk është zbatuar vendimi nr. 1, datë 04.09.2012 i KVVTP-së për shfuqizimin e plotë të AMTP-së, por janë kryer transaksione me këtë pasuri duke marrë si shpërblim shumë **448,000 lekë** në bazë të VKM nr. 61, datë 12.02.2014, **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë të gjitha masat, duke ndjekur hapat e nevojshëm ligjor, për të kërkuar në mënyrë administrative dhe ligjore, kthimin e shumës **448,000 lekë**, përfituar padrejtësisht nga pronari në pronësi të H. Zh.

24- Gjetje: ZVRPP Tiranë ka bërë regjistrimin e pasurive të paluajtshme me AMTP, në **3 raste**, të cilat nuk përmbajnë elementët e formës dhe përmbajtjes, veprime në papajtueshmëri me pikën 5, neni 45, të ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, bazuar në pikën “1”, neni 5, pikës “1”, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe në shkeljet e konstatuara, të dërgojë për shqyrtim në KVVTP Qarku

Tiranë, AMTP-të e konstatuara si të parregullta dhe njëkohësisht të nxjerrë urdhër kufizimi, për: pasurinë nr. 549, volum 7, faqe 59, pasurinë nr. 550/2 volum 7, faqe 90, pasurinë nr. 551/2, volum 7, faqe 91, pasurinë nr. 552/2, volum 7, faqe 92, të cilat i përkasin ZK 3878 Zall herr, për pasurinë nr. 412/6, volum 12, faqe 72, pasurisë nr. 400/13, volum 12, faqe 78, pasurinë nr. 146/18 volum 12, faqe 78. të cilat i përkasin ZK 1377 Çekrezë, për pasurinë nr. 412/6, volum 12, faqe 72, pasurisë nr. 400/13, volum 12, faqe 78, pasurinë nr. 146/18 volum 12, faqe 78. të cilat i përkasin ZK 1377 Çekrezë, pasurinë nr. 347/35 volum 12, faqe 12, të cilat i përkasin ZK 1377 Çekrezë, deri në përfundim të procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë së AMTP-ve.

25- Gjetje: ZVRPP Tiranë në 4 raste, ka regjistruar pasuritë: pasuria nr. 158- ND, ndërtesë me sipërfaqe 400 m², volumi 21, faqe 14, ZK 8360; pasuria nr. 5/673, ndërtesë me sipërfaqe 896 m², volumi 28, faqe 88, ZK. 8360; pasuria nr. 3/457, volumi 29, faqe 244, ZK8370; Pasuria nr. 9/633, truall, volumi 32, faqe 222, ZK 8330. *Konstatohet se, regjistrimi i pronës është bërë në mungesë dhe me parregullsi të dokumentacionit tekniko ligjor, si dhe sipërfaqja e ndërtimit regjistruar në KPP, nuk përputhet me të dhënat e Aktit të kolaudimit të objektit, me Lejen e ndërtimit dhe projektin e miratuar, duke regjistruar në 2 raste më tepër sipërfaqen e bazës së objektit, gjithashtu në një rast gjurma e ndërtimit të objektit nuk është në përputhje me plan vendosjen e miratuar, por është spostuar jashtë konturimit të sheshit të miratuar.*

Sa vepruar në papajtushmëri me, nenin 48, nenin 42, pikën 5 të nenit 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, bazuar në pikën “1”, neni 5, pikës “1”, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 158- ND, volumi 21, faqe 14, ZK 8360; për pasurinë nr. 5/673, volumi 28, faqe 88, ZK. 8360; për pasurinë nr. 3/457, volumi 29, faqe 244, ZK8370; për pasurinë nr. 9/633, volumi 32, faqe 222, ZK 8330, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

26- Gjetje: ZVRPP Tiranë ka regjistruar pasurinë nr. 2/280, volum 12, faqe 179, ZK 8340 dhe lëshuar certifikatë pronësie datë 25.08.2013, me të meta dhe parregullsi të dokumentacionit tekniko ligjorë.

Gjithashtu Akti administrativ Leje Legalizimi nr. 8641, datë 31.07.2012, mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi i pasurisë, nuk ka bazueshmëri ligjore dhe mund të ketë krijuar mundësinë e shmangies nga taksat lokale të urbanistikës, që për këtë rast llogaritet në vlerën 7,648,281 lekë, Leje Legalizimit është lëshuar në kundërshtim me me pikën 4, të nenit 2, nenin 36, kreu V “Legalizimi i shtesave në ndërtime”, të ligjit nr. 9462, datë 3.04.2006 ”Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme, është në papajtushmëri me nenin 48, nenin 49, me pikën 5, të nenit 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive

të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/280-ND, volum 12, faqe 179, ZK 8340, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe të kërkojë informacion nga Bashkia Tiranë lidhur me pagesat e taksave të urbanistikës.

27- Gjetje: ZVRPP Tiranë ka regjistruar pasurinë nr. 6/150, volum 21, faqe 68, ZK 8360, ndërtesë me sipërfaqe 2068 m² dhe lëshuar certifikatë pronësie datë 10.08.2013. Është konstatuar, se për regjistrimin në sistem të kësaj prone, ka mangësi në dokumentacionin tekniko ligjor të domosdoshëm për regjistrimin: **Mungon Formulari nr. 4**, i zbardhjes së Lejes së ndërtimit në favor të subjektit ndërtues “**H... Ndërtim**”, të miratuar sipas vendimit të KRRT-së nr. 56, datë 11.02.2005; sheshi i ndërtimit **nuk plotësohet me pronësinë mbi truallin**, sipas pjesëve takuese të pronarëve që zotërojnë lejen e sheshit të ndërtimit për sipërfaqen **prej 94.1 m²**(3401-3306.9); Sipërfaqja e ndërtimi prej **368 m²**(2068-1700), e regjistruar në KPP, rezulton se nuk ka dokumentacion përaktës, që të vërtetojë miratimin me vendim të KRRT-së, për sipërfaqen e ndërtimit të objektit **prej 368 m² dhe për këtë pjesë të objektit mungon Akt kolaudimi dhe Leja e shfrytëzimit.**

Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme pa origjinë prone, është në papajtushmëri me germën “a”, të nenit 25, me me nenin 42, me pikën 5 të nenit 44, nenin 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenin 12 dhe nenin 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, nenin 79, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi**, për pasurinë nr. 6/150, volum 21, faqe 68, ZK 8360, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

28- Gjetje: ZVRPP Tiranë ka regjistruar pasurinë nr. 10/258, volumi 27, faqe 146, ZK 8370 dhe lëshuar certifikatë pronësie, në mungesë të dokumentacionit tekniko ligjorë. Konstatohet se për regjistrimin në sistem të kësaj prone, nuk është kërkuar përputhshmëria me aktin administrativ Leje ndërtimi dhe me mungesë të dokumentacionit teknik ligjorë. Akti Kolaudimit nuk është hartuar sipas kërkesave ligjore , duke mos pasqyruar elementët kryesorë të përcaktimit të gjendjes së objektit dhe është hartuar në mungesë të Mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit; **Mungon Leja e Përdorimit të objektit, pasi nuk është lëshuar nga Bashkia Tiranë; Objekti është ndërtuar me një kat më tepër se leja e ndërtimit.**

Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme pa origjinë prone, është në papajtushmëri me germën “a”, të nenit 25, me me nenin 42, me pikën 5 të nenit 44, nenin 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenin 12 dhe nenin 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe nenin 45, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar, nenin 79, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi**, për pasurinë nr. 10/258, volumi 27, faqe 146, ZK 8370, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

29-Gjetje: ZVRPP Tiranë për zonën 2, nuk ka ndjekur procedurat për hartimin e dokumentacionit për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt e nuk ka kryer evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 lidhur me **24 vendimet** marrë nga Gjykata e Shkallës Parë Administrative Tirane, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë , për të cilat në **14 raste** ZVRPP ka qenë pale kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve të cilat i përkasin Zonës 2, në ZVRPP Tiranë të cilat i janë dërguar për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme dhe regjistrim “shtet” të **30 AMTP-ve për afro 50 pasuri, të urdhëruar kthimin me pronarë shtet**, për **24 vendime** me sipërfaqe totale prej **342,780 m²** për të cilat: shlyerje të detyrimit ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej **15050 m²** ne vlerën **6,742,400 lekë** dhe kufizim, kthim e regjistrim në pronësi ”shtet” të sipërfaqes prej **327,730 m² tokë bujqësore të llojit “arë”, ”vresht”, ”ullishtë”**.

-Në një rast nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen **327,730 m²**, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit.

-Në një rast nuk janë marrë masat përkatëse, për të siguruar dhe regjistruar “Shtet” për asnjë metër kundrejt **342,780 m²**, gjatë dhe pas përfundimit të procesit të shqyrtimit.

-Nuk janë vendosur barrë mbi pasuritë e tjetërsuar dhe nuk janë marrë masat përkatëse për të siguruar arkëtimin e vlerës prej **6,742,400 lekë**, që i përket vlerës së shitjes së tokës me sipërfaqe prej **15050 m²**, që në **2 raste** është tjetërsuar gjatë procesit të shqyrtimit në KVVTP, tjetërsimi i tyre ka sjellë si pasojë mundësinë e krijimit të një dëmi ekonomik për buxhetin e shtetit, pas marrjes së formës së prerë të vendimeve përkatëse.

-Në **4 raste** është lejuar tjetërsimi e shitja e pronës e kthyer “shtet” nga gjykata dhe KVVTP, në sipërfaqen prej **20160 m²**, duke krijuar mundësinë për moszbatim të vendimeve përkatëse të formës së prerë, për pasojë krijon mundësinë e shkaktimit të një dëmi ekonomik për buxhetin e shtetit, mosveprime dhe veprime këto ne kundërshtim me nenet 45, 59 , dhe neni 74, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me vetë Vendimet e Gjykatave, dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, të ndryshuar, që ka sjellë si pasojë lënien në gjendje juridike me pronësi të mbajtësit të paligjshëm dhe mos kalimin e titujve të pronësisë “Shtet”, pasqyruar në tabelën nr.1 “**ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2012-2015 zona nr. 2**”, bashkëlidhur (*Trajtuar hollësisht në faqen 134-209 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe të identifikojë pasuritë objekt Zona 2, të ndjekë procedurat për hartimin e dokumentacionit, regjistrimin, evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 lidhur me **24 vendimet** marrë nga Gjykata e Shkallës Pare Administrative Tirane, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve që i përkasin Zonës 2, ZVRPP Tiranë të dërguara **për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme dhe regjistrim “shtet” të 30 AMTP-ve me mbi 50 pasuri** me sipërfaqe totale prej **342,780 m²** për të cilat:

a. Të kërkojë shlyerje të detyrimit ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej **15050 m²** në vlerën **6,742,400 lekë**, si dhe **të vendosë barrë mbi to, deri në shlyerje dhe kufizim, kthim e regjistrim në pronësi "shtet", të sipërfaqes prej 327,730 m²** tokë bujqësore, të llojit "arë", "vresht", "ullishtë", në përputhje me vendimet e gjykatës, pasi ato të kenë marrë formë të prerë.

b. Të vendosë masat kufizuese, për pasuritë ku nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen **327,730 m²**, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit, deri në përfundimin e plotë të procesit të shqyrtimit.

c. Të marrë masa për të siguruar regjistrimin "Shtet" pasuritë (ku nuk është regjistruar "Shtet" asnjë metër) që i përkasin sipërfaqes **327,730 m²**, në përputhje edhe me vendimet përfundimtare.

d. Të kërkojë nëpërmjet rrugës ligjore, arkëtimin e dëmit ekonomik sipas vlerës përkatëse të tregut, për sipërfaqen **20160 m²**, të kthyer në pronësi "Shtet" sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe vendimeve të KVVTP, që rezultojnë e shitur pas marrjes së këtyre vendimeve, kjo referuar edhe vendimeve përfundimtare të shqyrtimit.

30- Gjetje: ZVRPP Tiranë ka bërë veprime mbi pasurinë **8/265 vol. 10, faqe 10, ZK 8340**, truell me sipërfaqe 13136 m², duke e ndarë në tre pasuri, për të realizuar procesin e shpronësimit në zbatim të **VKM nr. 752, datë 5.09.2013**, por rezultojnë se pas ndarjes sipërfaqja totale është shtuar në favor të qytetarit, me sipërfaqen prej **1758.4 m²**, e cila nuk ka dokumentacion lidhur me origjinën e pronës në favor të qytetarëve bashkëpronarë, të ndahej si pasuri e veçantë dhe të kalonte në pronësi të shtetit. Sa vepruar në kundërshtim me germën "a", neni 25, neni 34, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".

Rekomandim: ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe të identifikojë e të kthejë në pronësi të shtetit parcelën me sipërfaqe **1758.4 m²**, si dhe të vendosë barrë mbi pasuritë 8/263, vol. 23, faqe 118, pas. Nr. 8/264, vol. 23, faqe 119, dhe Pasuria nr. 8/265, vol. 23, faqe 120, deri në shlyerje, ZK 8340, deri në kalimin në pronësi të shtetit të truallit me sipërfaqe **1758.4 m²**.

31. Gjetje: ZVRPP Tiranë në **4 raste**, për **8 pasuri** me një sipërfaqe prej **44.740 m²** ka regjistruar pasuritë e paluajtshme të përfituara me AMTP pa qenë banor me datë 01.08.1991, për toka të refuzuara dhe pa kufizime të parcelave, veprime këto në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe shkronjën "b" pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 "Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)" dhe shkronja "a" pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione".

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 348/1 arë, volum 5, faqe 99, ZK 3051, nr. 391/1 arë, volum 10, faqe 191, ZK 3051, nr. 349/1 arë, volum 10, faqe 193, ZK 3051, nr. 392/5 arë, volum 10, faqe 164, ZK 3051, nr. 383/5 arë, volum 10, faqe 183, ZK 3051, nr. 234/12 arë, volum 9, faqe 198, ZK

2460 dhe nr. 187/14 arë, volum 10, faqe 136, ZK 2460, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

32. Gjetje: ZVRPP Tiranë në 2 raste, ka regjistruar leje legalizimi për referencë nr. 7095, ku mungon kontratat e shitblerjes së truallit nga ALUIZNI, dhe Referenca nr. 7213 për pasurinë 496/301 që nuk ka rrugë hyrje dalje në parcelë. Për të 2 rastet këto pasuri nuk duhej të ish regjistruar, duhej të ishte refuzuar për sigurimin e kontratës së shitblerjes së truallit dhe përmirësim të gen planit për rastin e dytë, mbasi nuk ka rrugë hyrje e dalje në objekt, veprim në papajtushmëri me pikën 5 neni 44 e neni 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin e Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 180/13 truall dhe ndërtesë, volum 34, faqe 186, ZK 2460 dhe nr. 496/301 truall dhe ndërtesë, volum 35, faqe 209, ZK 2460, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

33. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Tiranë në 3 raste, për 7 pasuri me një sipërfaqe prej 62.315 m² ka regjistruar pasuritë e paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”, të ndryshuar dhe me vendime gjykate, në dy raste nuk është cilësuar lloji i pasurisë së kthyer si truall, pyll apo arë dhe nuk ka urdhra për ndryshimin e zërit kadastral, veprime që duhet të miratoheshin nga organe kompetente si Këshilli i Qarkut apo Ministria e Bujqësisë. Në një rast, për Ref 01025 nuk na u vu në dispozicion për auditim, mbasi nuk është dorëzuar në arkiv nga ish juristi Dritan Babaj, pra si e tillë vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, me ndryshime dhe Rregulloren e ZQRPP nr. 2079, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko–ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” si dhe ligji nr. 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe nuk është arkëtuar vlera prej 304,200 lekë, për shërbimet e kryera apo vonesa në regjistrim veprime këto në papajtushmëri me nenin 39, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Për të tre rastet nuk janë verifikuar elementët e formës dhe të përmbajtjes të Aktit administrativ (vendimit të AKKP Tiranë dhe vendimet e Gjykatës), si dhe nuk janë plotësuar shtojca 2 e 3, veprim në papajtushmëri me nenin 42, pikën 5 nenin 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 18/53 pyll, volum 10, faqe 225, ZK 3051, nr. 18/62 pyll, volum 10, faqe 238, ZK 3051, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

34. Gjetje: ZVRPP Tiranë në 7 raste, në zonat urbane nr. 8120, 8170, 8140, 8150, 2460 dhe 3051, ka regjistruar leje ndërtimi duke u konstatuar mos përputhje të konfiguracionit të

objektit të ndërtuar me dokumentacionin ligjor, gjithashtu rezulton mbivendoje me pasuri shtet me 7/638 m², mos regjistrim sipërfaqe të përbashkëta për 4 objekte duke u krijuar dëme ekonomike, veprimet janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10 112, datë 09.04.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.”, dhe Ligjin Nr. 33/2012, datë 29.04.2012 për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, neni 50, “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa”, regjistrime të kateve mbi dokumentacionin ligjor të miratuar në dy raste, regjistruar 2 objekte pa leje shfrytëzimi dhe me sipërfaqe më të mëdha se projekti, regjistruar leje legalizimi objekti “godinë banimi dhe shërbimi 1, 5 dhe 7 kat, me 1 kat parkim nëntokë”, që vjen në kundërshtim me pikën 4, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, i ndryshuar që shpreh: Fusha e veprimit të këtij ligji nuk shtrihet për ndërtimet pa leje të ngritura mbi troje private brenda vijës së verdhë, kur planet rregulluese urbanistike parashikojnë ndërtime mbi 5 kate nga niveli zero, etj veprime me mospërputhje me nenet 23 dhe 42 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 4 të shtojcën nr. 2 të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve, që verifikohen nga ZVRPP dhe të procedurës për nxjerrjen e Urdhrit të regjistruesit”, ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 8402, datë 17.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi**, për pasuritë nr. 7/276 truall dhe ndërtesë, volum 5, faqe 242 ZK 8170, nr. 9/836 truall dhe ndërtesë, volum 44, faqe 242 ZK 8120, nr. 609/2 truall dhe ndërtesë, volum 34, faqe 5-25, ZK 8140, nr. 5/592 truall dhe ndërtesë, volum 48, faqe 200 ZK 8150, nr. 609/1 truall dhe ndërtesë, volum 35, faqe 213 ZK 2460, nr. 609/2 truall dhe ndërtesë, volum 35, faqe 214, ZK 2460 dhe nr. 8/13 truall dhe ndërtesë, volum 10, faqe 67 ZK 3051, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

35. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Tiranë në 7 raste, për 11 pasuri për veprimet e kryera në pasuritë me AMTP sipas vendimeve të Gjykatës së Shkallës Pare Administrative Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVT) Prefekti Qarkut Tiranë gjatë vitit 2013, 2014 dhe 2015 që i përkasin juridiksionit të Zonës 3 Tiranë, **doli se nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen 38.063 m²**, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit,

-nuk janë vendosur barrë mbi pasuritë e tjetërsuar në 1 rast për vlerën prej 1,299,200 lekë që ka sjellë si pasojë mos arkëtim dhe që përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, mosveprime dhe veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me vetë Vendimet e Gjykatave, dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, të ndryshuar, që ka sjellë si pasojë lënien në gjendje juridike me pronësi të mbajtësit të paligjshëm dhe mos kalimin e titujve të pronësisë “Shtet”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë nr. 75/15 arë, volum 2, faqe 27, ZK 2380, nr. 906 arë, volum 7, faqe 217, ZK 2460,

nr. 914 arë, volum 7, faqe 225, ZK 2460, nr. 924/4 arë, volum 9, faqe 145, ZK 2460, nr. 27/8 arë, volum 6, faqe 7, ZK 3425, nr. 27/4 arë, volum 2, faqe 128, ZK 3425, nr. 27/10 arë, volum 6, faqe 9, ZK 3425, nr. 498/2/1 arë, volum 1, faqe 1, ZK 2460, nr. 63/18 arë, volum 10, faqe 7, ZK 3051, nr. s'ka arë, volum 2, faqe 128, ZK 2460, nr. s'ka arë, volum 4, faqe 32, ZK 2460, nr. 159/2 arë, volum 4, faqe 154, ZK 3051 dhe nr. 236/1 arë, volum 9, faqe 188 ZK 3051 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

36. Gjetje: ZVRPP Tiranë, në regjistrimin e pallateve zona 4, nuk ka regjistruar në seksionin përkatës të KPP-ve, pra të KPP “mëmë” nr.4/83, v.31, f.124 zk.8270 truall 1260 m², me 1401 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 640 m², e llojit pallat dhe nr. 8/743, v. 31 fq.170, e llojit pallat trualli 1500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 682 m², dhe nuk ka llogaritur nuk ka ndalur taksën e kalimit të pronësisë përkatësisht ndaj firmës “Akimed 2001” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët prej **795,4 m²** në vlerën prej **795,400 lekë** (795,4 m² x 1000 lekë/m²/ndërtim) dhe ndaj “Domus” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët **1014,69 m²** në vlerën prej **1,014,690 lekë** (**1014,69 m²** x 1000 lekë/m²/ndërtim), si dhe shumën prej **45,990 lekë, ndaj personave për kontrata shitje, shuma qe përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në kundërshtim** me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50 “**Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa**”, pika 2, dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.1996“Për Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar neni 28, “**Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**”, pika 2 .

Rekomandim: ZVRPP Tiranë Regjistruesi të vendosë masë kufizimi në seksionin përkatës të KPP-ve, pra të KPP “mëmë” nr.4/83, v.31, f.124 zk.8270 truall 1260 m², me 1401 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 640 m² e llojit pallat dhe në KPP nr. 8/743, v. 31 fq.170, e llojit pallat trualli 1500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 682 m², deri në llogaritjen dhe arkëtimin taksën e kalimit të pronësisë përkatësisht ndaj firmës “A.....” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët prej **795,4 m²** në vlerën prej **795,400 lekë** (795,4 m² x 1000 lekë/m²/ndërtim) dhe ndaj “D....s” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët prej **1014,69 m²** në vlerën prej **1,014,690 lekë** (**1014,69 m²**x1000 lekë/m²/ndërtim),(vlera të cilat blerësit qytetar i kanë paguar në çmim të blerjes) deri në arkëtimin e vlerave të mësipërme nga firmat përkatëse ndërtuese, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **45,990 lekë ndaj personave për kontrata shitje, shuma qe përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

37.Gjetje: ZVRPP Tiranë për zonën 4, nuk ka ndjekur procedurat për hartimin e dokumentacionit për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt e nuk ka kryer evidentimin e raportimin e ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015, lidhur me **16 vendimet** e Gjykatave të Shkallës Pare Administrative Tirane, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë nga të cilat në **12 raste** ZVRPP ka qenë pale kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve për Zonës 4, në ZVRPP Tiranë të cilat janë dërguar për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme dhe regjistrim “shtet”, të **21 AMTP-ve** me **mbi 37 pasuri** me sipërfaqe totale prej **152372 m²** dhe konkretisht: shlyerje të detyrimit në vlerën **5,479,500 lekë** ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej **12740 m²** dhe kufizim, kthim e regjistrim në pronësi “shtet” të sipërfaqes prej **146872 m²** tokë bujqësore të llojit “arë”, “vresht”, “ullisht”.

-Masë kufizimi është vendosur vetëm në **2 raste** për sipërfaqen **16 010 m²**, dhe nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen **124 362 m²**, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit,

-nuk është regjistruar “Shtet” asnjë metër kundrejt **140 373 m²**,

-nuk janë vendosur barrë mbi pasuritë e tjetërsuar në **2 raste** për **12 740 m²**, me vlerën prej **5,479,500 lekë**, që ka sjellë si pasojë mos arkëtim dhe **që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**,

-është lejuar tjetërsimi e shitja e pronës “shtet” në **2 raste** në sipërfaqen prej **6500 m²** (e kthyer “shtet” nga gjykata, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëmin ekonomik në vlerën prej mbi **21,045,000 lekë**, sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes; mosveprime dhe veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me vetë Vendimet e Gjykatave, dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, të ndryshuar, që ka sjellë si pasojë lënien në gjendje juridike me pronësi të mbajtësit të paligjshëm dhe mos kalimin e titujve të pronësisë “Shtet”, pasqyruar në tabelën nr. “**ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v.2012-2015 zona nr. 4**”, bashkëlidhur Projektraporti të Auditimi.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të identifikojë pasuritë objekt në zonën 4, të ndjekë procedurat për hartimin e dokumentacionit, regjistrimin, evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 dhe zbatimin e pasqyrimit në KPP lidhur me **16 vendimet** e Gjykatës Shkallës Pare Administrative Tirane, Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë për të cilat në **12 raste**, ZVRPP ka qenë palë kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve, sipas vendimeve që i përkasin Zonës 4 të ZVRPP Tiranë të dërguara për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme dhe regjistrim “shtet” të **21 AMTP-ve** me **mbi 37pasuri** me sipërfaqe totale prej **152372 m²** për të cilat:

a.-Të kërkojë shlyerje të detyrimit të shtetit në vlerën **5,479,500 lekë ndaj personave përkatës**, për sipërfaqen e tjetërsuar prej **12740 m²** dhe **të vendosë kufizim, kthim e regjistrim** në pronësi “shtet” të sipërfaqes **146872 m²**, tokë bujqësore llojit “arë”, “vresht”, “ullishtë”.

b -Të vendosë masat kufizuese (pasi masë kufizimi është vendosur vetëm në 2 raste për sipërfaqen 16 010 m²), për pasuritë ku nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen **124 362 m²**, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit,

c.- Të regjistrojë “Shtet” pasuritë (ku nuk është regjistruar “Shtet” asnjë metër) që i përkasin sipërfaqes **140 373 m²**,

d.-Të kërkojë dhe sigurojë shlyerjen e dëmit ekonomik për pasuritë e tjetërsuar në 2 raste për sipërfaqen 12 740 m² me vlerën prej 5,479,500 lekë, si dhe të vendosë barrë mbi to deri në shlyerjen e detyrimit vlerësuar nga gjykata, mosveprim që ka sjellë si pasojë mos arkëtim e detyrimit dhe që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit,

e. Të kërkojë nëpërmjet rrugës ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë përkatëse të tregut për sipërfaqen e shitur prej **3500 m²** “Shet” dhe të vlerës prej **21,045,000 lekë, sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes për sipërfaqen 3000m² pronë “Shtet”**; (sipas konstatimit -është lejuar tjetërsimi e shitja e pronës shtet në 2 raste në sipërfaqen prej 6500

m²(sipërfaqe “shtet” kthyer nga gjykata), duke i shkaktuar buxhetit të shtetit **dëmin ekonomik në vlerën mbi 21,045,000 lekë sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes** pasqyruar në tabelën. “ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v.2012-2015 zona nr. 4”.

38.Gjetje: Nga auditimi i vendimeve të KVVTP Prefekti Qarkut Tiranë dhe Vendimeve të Gjykatave e Shkallës Pare Administrative Tirane me palë paditëse Prefekti Qarkut Tiranë, të paditur mbajtësit përkatës të titujve të pronësisë me AMTP, përfaqësues të familjeve bujqësore dhe palë e tretë ZVRPP Tiranë (ku në 12 raste ka qenë palë kërkuese), rezulton se ZVRPP Tiranë gjithnjë ka qenë në mungesë, duke mos marrë pjesë në gjykim. pasqyruar në tabelën “ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v.2012-2015 zona nr. 4”, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimi .

Rekomandim:- Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të marrë masa për pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, të shqyrtojë, analizojë dhe të zbatojë procedurat, hartojë dokumentacionin për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt gjykimi, kryejë evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe të bëjë pasqyrimin në KPP për **vendimet e gjykatës e të KVVTP** të vitit 2012, 2013, 2014 dhe 2015, ku ZVRPP Tiranë si palë e tretë apo e paditur gjithnjë ka **qenë në mungesë**, pasqyruar në tabelën “ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v.2012-2015 ZONA nr. 4” .

39. Gjetje: ZVRPP Tiranë nuk ka evidentim e ndjekje me evidencat përkatëse, nuk ka njohje e raportim të gjendjes së pasurive të regjistruara me mbivendosje, ndjekje të procedurave ligjore, si dhe nuk raportohet ecuria e zgjidhjes dhe pjesëmarrja e kësaj zyre në seancat gjyqësore për këto çështje; dhe gjithashtu ka moszbatim të procedurave dhe afateve lidhur me veprimet e regjistrimit, ka trajtim të pabarabartë të palëve dhe nxjerrje të njëanshme pa u njoftuar njëkohësisht ka nxjerrë urdhër kufizimin **nr.3503, datë 30.12.2014, dhe referencën nr. 0817, datë 30.10.2014, për aplikimin nr. 52750, datë 03.10.2014, dhe nuk ka ndjekje të radhës në regjistrim lidhur me pasuritë nr. 8/409 v.24, f.55, zk.8330 truall me sip. 1817 m², dhe mbi pasurinë nr. 8/410 v.24, f.56, zk.8330 truall me sip. 1817 m², etj,** veprime dhe mosveprime në kundërshtim me procedurat me nenin 37, “Përparësia në regjistrim“ pasi nuk ka zbatuar procedurat: evidentimin e mbivendosjes, nxjerrje urdhri të veçantë, refuzimin e regjistrimit për pjesën e mbivendosur, për atë pjesë (sikundër është lëshuar certifikata datë 21.7.2014), si dhe orientimin njoftimin e palëve për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative a gjyqësore; sipas ligjit nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”; si dhe është në kundërshtim me afatet ligjore të përcaktuar në KPA dhe në rregullore, lidhur me vonesën e mosdhënie zgjidhje qytetarit për aplikimin nr. 52750, datë 03.10.2014” .

Rekomandim: ZVRPP Tiranë, Regjistruesi të marrë masa, me urdhër të veçantë të bëjë rregullimet e duhura ligjore dhe regjistrimet e sakta në KPP-të e pasurive nr. 8/409 v.24, f.55, zk.8330 truall me sip. 1817 m², dhe mbi pasurinë nr. 8/410 v.24, f.56, zk.8330 truall me sip. 1817 m², dhe të zbatojë procedurat ligjore të mbivendosjes, duke respektuar refuzimin e regjistrimit për pjesën e mbivendosur, për atë pjesë (sikundër është lëshuar certifikata datë 21.7.2014 si dhe të bëjë orientimin njoftimin e palëve për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative a gjyqësore; duke dëshmuar parregullsitë e punonjësit lidhur me aplikimin nr. 52750, datë 03.10.2014 dhe parregullsinë e KPP-ve.

40. Gjetje: ZVRPP Tiranë me aplikimin nr. 93682, datë 11.06.2013, praktikë mbetur në proces tej afateve, ka kryer veprime dhe mos veprime në tejkalim të kompetencave të detyrës me pasojë mos regjistrimi dhe humbjen e të drejtave të pronësisë nëpërmjet pasqyrimit të pavërtetë në KPP të pasurisë nr. 4/175, v. 15, f.114, zk.8160, truall me sipërfaqe totale 120 m², nga e cila truall 120 m², prej të cilës 80 m² ndërtesë, në emër të Qytetari pronari Ylli Hoxha, (duke shpërdoruar KPP-në, ngatërruar e referuar një KPP-je tjetër KPP v.40, fq. 139 ZK. 8160, ku ndodhet e regjistruar pasuria nr. 5/112-G1 garazh, në emër të “Star Construcion”, duke mos respektuar afatet dhe procedurat ligjore, mos shqyrtuar e mos marrë në konsideratë dokumentacionin dhe mos vepruar minimalisht konformë nenit 25/b, pra në tejkalim të kompetencave dhe të detyrës dhe në kundërshtim të hapur me nenet 25, 29, 37 dhe 45 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: ZVRPP Tiranë Regjistruesi të marrë masa, me urdhër të veçantë të bëjë rregullimet e duhura ligjore dhe regjistrimet e sakta në KPP-të e pasurive nr. 4/175, v. 15, f.114, zk.8160 truall me sipërfaqe totale 120 m², nga e cila truall 120 m², prej të cilës 80 m² ndërtesë, të fshijë referencat dhe shënimet e pasakta në seksionet “B”, “C” dhe “D”, duke i dhënë KPP formën e përmbajtjen e duhur ligjore, si dhe të marrë në konsideratë dokumentacionin (vërtetimi vendim nr. 9, datë 27.2.1990 i K.Ekz. KP Rajonit nr.1, që vërteton shitjen e shtëpisë, si dhe vërtetimi datë 13 Maj 1994, i nd/jes Komunale banesa nr.3, sipas të cilit ka bërë punime për ndërtimin e 1 dhome plus 1 korridori); fakte këto që duhen marrë në konsideratë për trajtimin e pronësisë së truallit), si dhe të inventarizojë dokumentacionin e praktikës së aplikimit nr. 93682, datë 11.06.2013.

41. Gjetje: ZVRPP Tiranë me referencën nr.3686, datë 5.12.2014, ka kryer veprimin shënim “Bllokim”, (veprim i mbetur në fuqi prej 11 muajsh tej afateve), në KPP- të e 13 pasurive dhe pasurisë v.6, f.36, zk. 3976, pas nr. 155/67, me sip 1600 m² “arë”, në emër të K Q, veprim i cili është “NUL”, pasi rezulton pa dokumentacionin e nevojshëm sipas formës e përmbajtjes dhe në kundërshtim me procedurat përcaktuar në nenin 59, pika 3, e ligjit nr. 33/2012 datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pra dhe në kundërshtim me Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, “Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, kreu VI”Trajtimi i PPL pas Regjistrimit Fillestar”, regjistrimet e grupit 5.2.2, paragrafi IX .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, duke nxjerrë urdhër të veçantë për shfuqizimin e shkresës nr. 20275/1, datë 16.12.2014, që ka sjellë veprimin “nul” të bllokimit, të bëjë rregullimet e duhura ligjore dhe regjistrimet e sakta në KPP-të e 13 pasurive bujqësore dhe të pasurisë nr. 155/67, v.6, f.36, zk. 3976, me sip 1600 m² “arë”, në emër të K.Q, veprim i cili është “NUL” pasi rezulton pa dokumentacionin e nevojshëm sipas formës e përmbajtjes ligjore; si dhe të njoftojë zyrtarisht qytetarin.

42. Gjetje: ZVRPP Tiranë në 1 rast, ka bërë regjistrimin e pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, pa administruar një titull të ligjshëm pronësor mbi sipërfaqen e pasurisë të llojit truall, pasuria nr. 2/677, dhe pa u administruar në referencë asnjë dokument për pasurinë nr. 2/676, veprime në mospërputhje me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin

tekniko-ligjor, **të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/677, vol. 36 faqe 154, me sipërfaqe trualli 455.5 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 205 m² dhe pasurinë nr. 2/676, në volum 36 faqe 153, për sipërfaqen e truallit prej 404.46 m², të ndodhura në zonën kadastrave nr. 8350.

43. Gjetje: ZVRPP Tiranë në **1 rast**, ka bërë regjistrimin e pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, pa administruar një titull të ligjshëm pronësor mbi sipërfaqen e pasurisë të llojit objekt, regjistruar me nr. 3/67-ND, volum, 28 faqe 138, pasi leja e ndërtimit rezultoi e lëshuar për një subjekt të ndryshëm dhe regjistrimi është bërë për një tjetër subjekt, si dhe me mangësi dokumentare e hartografike përse i përket dokumentacionit të vet lejes dhe pozicionimit të ndërtimit sipas lejes dhe HTR të ZVRPP, veprime në mospërputhje me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Po ashtu është vepruar pa llogaritur më parë penalitetet në regjistrim duke **shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë prej 170,500 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 39 të ligjit 33/2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe shlyerjen e detyrimit në vlerë prej 175,500 lekë, **të nxjerrë urdhër kufizimi** për nr. 3/67-ND, volum, 28 faqe 138, të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8230.

44. Gjetje: ZVRPP Tiranë në **1 rast**, ka bërë regjistrimin e pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, pa llogaritur më parë penalitetet në regjistrim duke **shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë prej 300,000 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 39 të ligjit 33/2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në shlyerjen e detyrimit në vlerë prej 300,000 lekë, **të nxjerrë urdhër kufizimi** për nr. 3/320/ND, volum, 29 faqe 3, të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8230.

45. Gjetje: ZVRPP Tiranë në **1 rast**, ka bërë regjistrimin e pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, për pasurinë nr. 3/659, volum, 8 faqe 85, me sipërfaqe trualli prej 875 m², referuar një vendimi gjyqësor, por pa kryer më parë një pozicionim të pronës së mëparshme të subjektit dhe asaj të shkëmbyer me vendimin nr. 42, datë 12.04.1963, pozicionimin aktual të tyre, pa përcaktuar dhe evidentuar se mbi çfarë dokumenti ka figuruar në hartat e ZVRPP shtëpia e banimit të paditësit, edhe pse eksperti i referohet regjistrit hipotekor nr. 320, datë 23.0.1980, kryer mbi bazën e vërtetimit fakti nr. 84, datë 24.01.1961 të Gjykatës Popullore Tiranë, që bën fjalë për pronën përpara realizimit të shkëmbimit (nëse është finalizuar). Është kryer regjistrimi pa bërë lidhje ndërmjet pronës së regjistruar në sistemin hipotekor me nr. 320, datë 23.0.1980 dhe asaj aktuale me nr. 3/659, volum, 8 faqe 85, duke lejuar që subjekti të ketë dy regjistrime për të njëjtën pronë por me sipërfaqe të ndryshme, ose subjekti të ketë përfitur dy herë, duke mbajtur në pronësi të tij si pronën e origjinës ashtu edhe atë të përfitur nga kontrata e shkëmbimit, veprime në mospërputhje me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tirana të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe saktësimin të regjistrimeve, **të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr.

3/659, volum, 8 faqe 85, me sipërfaqe trualli prej **875 m²** dhe objekti ska m², të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8230.

46. Gjetje: ZVRPP Tiranë në **1 rast**, ka bërë regjistrimin e pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, për pasurinë të llojit truall, pasuria nr. 7/588, volum, 28 faqe 85, me sipërfaqe trualli prej **19195 m²** dhe objekti **16100 m²**, kur ka mospërputhje të sipërfaqes së njohur me atë të kthyer, kompensuar, dhe njohur e drejta e parablerjes së objekteve, kur rezulton se subjektit i është njohur e drejta e parablerjes për një sipërfaqe prej **32340 m²**, e cila nuk ka qenë pjesë e pronës së njohur këtij subjekti, si dhe në mungesë të një pjesë të dokumentacionit tekniko/ligjor, pa kërkuar konfirmimet e duhura ligjore si nga Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Sektori i Shitjes së Pronave Publike, ashtu dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pikërisht për saktësimin e të gjithë pjesëve të dispozitivit të vendimit nr. 322, datë 16.01.1995, si dhe nëse pjesa për të cilën është ushtruar e drejta e parablerjes është pjesë e pronës së njohur apo jo dhe nëse po është e njohur për kompensim apo ushtrim të drejtë parablerje, por dhe kthimin e pronës për sipërfaqen jashtë objektit të privatizuar. Veprime në mospërputhje me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 7/588, volum, 28 faqe 85, të ndodhura në zonën kadastrave nr. 8230.

47. Gjetje: ZVRPP Tiranë në **1 rast**, ka bërë regjistrimin e pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, për pasurinë të llojit truall, pasuria nr. 7/576 volum, 28 faqe 69, me sipërfaqe trualli prej 2280 m² dhe objekti 1341 m², kur ka mospërputhje të sipërfaqes së njohur me atë të kthyer, kompensuar, dhe njohur e drejta e parablerjes së objekteve, kur rezulton se subjektit i është njohur e drejta e parablerjes për një sipërfaqe prej 32340 m² e cila nuk ka qenë pjesë e pronës së njohur këtij subjekti, si dhe në mungesë të një pjesë të dokumentacionit tekniko/ligjor, pa kërkuar konfirmimet e duhura ligjore si nga Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Sektori i Shitjes së Pronave Publike, ashtu dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pikërisht për saktësimin e të gjithë pjesëve të dispozitivit të vendimit nr. 322, datë 16.01.1995, si dhe nëse pjesa për të cilën është ushtruar e drejta e parablerjes është pjesë e pronës së njohur apo jo dhe nëse po është e njohur për kompensim apo ushtrim të drejtë parablerje, por dhe kthimin e pronës për sipërfaqen jashtë objektit të privatizuar. Veprime në mospërputhje me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 7/576, volum, 28 faqe 69, të ndodhura në zonën kadastrave nr. 8230.

48. Gjetje: ZVRPP Tiranë në **1 rast**, ka bërë regjistrimin e pasurisë Pallat, “*Godinë banimi dhe shërbime 10 kat me 1 kat parkim nëntokë*” të miratuar me Vendim KRRT-je nr. 37/3,4, datë 21.07.2001 dhe nr. 219, datë 26.04.2005”, kur ka rezultuar se objekti është ndërtuar pjesërisht mbi pasurinë e fituar me kontratë nr. 202 rep., nr.71 kol., datë 28.01.2000, ndërmjet shitësit B.P dhe blerësit K.N, për sipërfaqe toke prej 800 m² për objektin 6/202

(reparti mekanik), madje dhe leja e ndërtimit është shënuar shprehimisht: "...Familjes P, N, D...", si dhe ndërtuar e investuar nga "A.... Konstruksion shpk" dhe R.J. Mos vlerësimi i dokumentacionit, dhe kryerja e regjistrimit pa përcaktuar qartë dhe saktë zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve ndaj gjithë pronarëve të truallit, duke vendosur dhe kufizimet përkatëse deri në përcaktimin e plotë të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore nga palët kontraktuese për pjesët takuese për çdo palë, janë në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*", dhe udhëzimin nr. 3, datë 3.10.2012 "*Për caktimin e kriterëve e të procedurave për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin në cilësinë e investitorit e të pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njësive individuale të objektit në fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar*".

Gjithashtu nuk është trajtuar Urdhri i kufizimit me nr. 441, datë 15.03.2011 i lëshuar nga regjistruesi, në zbatim të shkresës nr. 375/10, datë 07.02.2011 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, **duke mos reflektuar Urdhrin e kufizimit në trajtimin me truallin dhe pronarët, por kanë kryer dhe lejuar shitjen dhe regjistrimin e pronave, pa u përcaktuar pjesët takuese dhe masa e kufizimit dhe pa argumentim mbi ngjarjen e re që ka nxjerrë rrethana apo prova të reja për heqjen e kufizimit**, (çertifikata nr. 964149, datë 04.12.2014 për pasurinë nr. 6/256, vol. 22, fq. 94, truall me sipërfaqe prej 250 m²), veprime në kundërshtim me nenin 59, pika 3, e ligjit nr. 33/2012 datë 21.3.2012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*" dhe ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 "*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*", bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe zgjidhjen e marrëdhënies së pronësisë mbi truallin, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë "*Godinë banimi dhe shërbime 10 kat me 1 kat parkim nëntokë*" të miratuar me Vendim KRRT-je nr. 37/3,4, datë 21.07.2001 dhe nr. 219, datë 26.04.2005", ndërtuar e investuar nga "Aurora Konstruksion shpk", të ndodhura në zonën kadastrave nr. 8230.

49.Gjetje: ZVRPP Tiranë deri më datën e përfundimit të auditimit në terren, nuk vuri në dispozicion të KLSH referencat e Zonës kadastrale 8230; Referenca nr. 10198, pasuria 6/333-ND, volum 28 faqe 100, ndërtesë me sipërfaqe 170 m², lëshuar certifikata e pronësisë më datë 14.10.2013 (titulli i pronësisë sipas shënimit rezulton Leje ndërtimi); Referenca nr. 10068, pasuria 3/392, volum 28 faqe 27, truall me sipërfaqe 500 m² truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 147 m², lëshuar certifikata e pronësisë më datë 25.07.2013. (titulli i pronësisë sipas shënimit rezulton vendimi gjyqësor nr. 610, datë 13.04.2013); Referenca nr. 10278, pasuria 2/1022, volum 28 faqe 118, truall me sipërfaqe 433.8 m² truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 223 m², lëshuar certifikata e pronësisë më datë 12.12.2013. (titulli i pronësisë sipas shënimit rezulton leje legalizimi nr. 35907, datë 07.01.2013) si dhe Zona kadastrale 8350, Referenca nr. 13076, pasuria 5/607, volum 36 faqe 164, truall me sipërfaqe 151.7 m² truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 90.3 m², lëshuar certifikata e pronësisë më datë 13.09.2013 (titulli i pronësisë sipas shënimit rezulton leje legalizimi). Veprime në kundërshtim me Rregulloren nr. 2079, datë 11.06.2007 "*Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në ZVRPP*", ligjit nr. 33/2012 datë 21.3.2012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*" dhe ligjit nr.

154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, për arkivimin e referencave të punuara e të pa dorëzuara nga specialistët, në arkivin e institucionit.

50.Gjetje: ZVRPP Tiranë nuk ka zbatuar plotësisht, rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të dërguara respektivisht me shkresat nr. 732/25, datë 04.07.2008, nr. 375/10, datë 07.02.2011 dhe nr. 577/15, datë 22.01.2014, pasi nga auditimi janë konstatuar raste të mos zbatimit të tyre, raste të nxjerrjes së urdhrave kufizuese por mos pasqyrimi i tyre në regjistrat e ZVRPP, apo dhe raste të heqjes së urdhrave kufizuese, pa u realizuar asnjë ngjarje për të përligjur procedurat, duke sjellë për pasojë lejimin dhe kryerjen e transaksioneve, mbi pasuri të përfituara në mënyrë të kundraligjshme nga poseduesit e tyre apo regjistruara në mënyrë të kundraligjshme nga institucioni, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe në ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të evidentojë të gjitha pasuritë për të cilat KLSH ka rekomanduar masa kufizuese por që ende rezultojnë të pa kufizuara, si dhe për të gjitha rastet e tjera të heqjes së kufizimeve nga vet ZVRPP, pa pasur një ngjarje ligjore për të përligjur procedurat, të veprojë sipas referencave të mësipërme. Evidentimi i rasteve të moszbatimit apo tjetërsimit të rekomandimeve të KLSH ti referohet procesverbalit nr. 33, datë 20.11.2015.

51. Gjetje: ZVRPP Tiranë në 1 rast, ka bërë regjistrimin e pasurisë nr. 6/871, volum, 36 faqe 87, referenca nr. 12772, datë 21.08.2013, zk. 8350. Sipas KPP subjektit fillimisht i është regjistruar një sipërfaqe truall prej 426.91 m², sipas LN, dhe më tej është regjistruar truall prej 459 m² dhe objekt 87.80 m². Sipas inventarit datë 02.04.2013, bërë nga kompania “Tracasa”, dokumentacioni mbi pronësinë ka vetëm një dokument, kontratën e dhurimit nr. 3905 rep., 963 kol. datë 04.06.1997, për një truall të ndodhur në lagjen 17 Nëntori me sipërfaqe prej 459.5 m². Në KPP është vendosur shënimi Vijon nga vol. 36, faqe 232, ref. 16402, por nga verifikimi rezulton se shënimi i vendosur nuk ka lidhje me këtë pasuri, por bënë fjalë për një tjetër pasuri e pronarë të tjerë.

Në përfundim nga ZVRPP Tiranë, është kryer regjistrimi i pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, pa administruar një titull të ligjshëm pronësor mbi pasurinë e llojit truall dhe objekt, apo pa u bërë lidhja e regjistrimeve të mëparshme me sistemin e regjistrimit fillestar, veprime në mospërputhje me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar më hollësisht në faqet 243-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tirana të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe lidhjen ndërmjet regjistrimeve, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 6/871, volum, 36 faqe 87, të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8350.

52. Gjetje: Nga shqyrtimi i praktikave të ZVRPP për heqjen e kufizimeve të mëparshme të vendosura në zbatim të rekomandimeve të KLSH (rekomandimet e lëna me shkresën nr. 732/25, datë 04.07.2008, për zonën nr. 3) rezultoi se *veprimet procedurale për heqjen e kufizimeve aktualisht i referohen shkresës së Kryeregjistruesit nr. 6697/1, datë 10.07.2014, me objekt “Në lidhje me kërkesën për mendime nr. 12539, datë 08.07.2014 të ZVRPP Tiranë”*. Sipas shkresës të ZQRPP lidhur me kufizimet e rekomanduara nga KLSH nuk jemi në kushtet e nenit 75 por të nenit 59 të ligjit 33/2012, ku përcaktohet se afati i vendosjes së kufizimit është 30 ditë në rast të mosparaqitjes së një vendimi gjyqësor për marrjen e masave për sigurimin e padisë nga subjekti i interesuar, sipas përcaktimeve të nenit 202 të Kodit Civil, Regjistruesi është i detyruar të heqë kufizimin e regjistruar, sipas pikës 1 të këtij neni. Pra në kushtet kur nuk rezulton që nga momenti i vendosjes së kufizimit të jetë marrë ndonjë masë për sigurimin e padisë për vendimet e ish-KKKP, apo këto vendime të jenë shfuqizuar nga institucionet përkatëse, AKKP apo Avokatura e Shtetit, si dhe faktin e pushimit të çështjes penale nga Prokuroria e Rrethit Tiranë, Regjistruesit të ZVRPP i lind drejta të ritrajtojë të gjitha kufizimet rast pas rasti për heqjen e kufizimit për këto pasuri nëse nuk jemi përpara kushteve të parashikuara në nenin 75 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tirana për të gjitha rastet e kufizimeve të mëparshme të rekomanduara nga KLSH, të mos veprojë referuar në shkresën e ZQRPP nr. 6697/1, datë 10.07.2014, por të procedojë vetëm në bazë të dokumentacionit ligjor, si vendimeve gjyqësore të formës së prerë, rekomandimeve të KLSH apo vendimeve të lëshuara nga organet të cilat kanë për kompetencë ligjore trajtimin e rasteve, procedurë në zbatim të nenit 59 dhe 75 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

52. Gjetje: Nga shqyrtimi i KPP të zonës nr. 5 u konstatuan raste ku kartelat ishin të pa plotësuar, pra boshe, dhe konkretisht:

Zona kadastrale 8230, volum 27, faqet 128-159 dhe 161-250

Zona kadastrale 8230, volum 28, faqet 150-155, 157, 171, 178, 200 dhe 204-207

Zona kadastrale 8240, volum 08, faqet 121-126, 129, 133-134 dhe 145.

Zona kadastrale 8350, volum 37, faqet 63-68, 74-104, 108, 126-127, 133-134, 138-139, 149, 163-164 dhe 167-169

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tirana për të gjitha rastet e KPP të paplotësuar, pra boshe, të cilave u ka kaluar numri, të nxjerrë urdhër për anulimin e tyre dhe të vendos shënimin përkatës në secilën KPP, procedurë kjo në zbatim të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe

procedurat përmbardimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **228,513,887 lekë**, si më poshtë si më poshtë:

1- Gjetje: Regjistrimi i kontratës së shitjes nr. 11296 rep, nr. 3527 kol, në datë 12.11.2010, sipas *Ref nr. 6990*, ndërmjet shoqërisë “AL H..... Konstruksion” Sh.p.k në cilësinë e shitësit dhe V.N, Y.B, A.H në cilësinë e blerësve, për sipërfaqen e truallit 5920 m², pasurisë nr. 3/22, v.13, fq.51, zk. 8210, ku çmimi i shitjes sipas nenit 2 të kontratës është 8,000,000 euro, është bërë me vonesë, pasi afati është jo më shumë se 3 ditë nga lidhja e kontratës, pra datë e lidhjes 12.11.2010, regjistrimi duhet të bëhej në datë 15.11.2010. Në KPP e punuar nga specialisti përkatës dhe firmosur, Ref. 6990 nuk ka datë por gjëndet shënimi “*Dorëzuar me datë 10.02.2011*”, *datë 22.02.2011*”, pra është praktikë e regjistruar me vonesë për gati 100 ditë (22.02.2011-12.11.2010) x 2750 lekë (*Tarifa e regjistrimit*)= **27,500 lekë**. Nuk është llogaritur e ndalur vonesa në regjistrim prej 100 ditësh, vonesë e cila ka shkaktuar një **dëm ekonomik në vlerë 27,500 lekë**, në kundërshtim me nenin 39 “Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim” i ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Nga ZVRPP Tiranë të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **27,500 lekë** e shkaktuar nga vonesa në regjistrim prej 100 ditësh kontratës së shitjes nr. 11296 rep, nr. 3527 kol, në datë 12.11.2010, sipas *Ref nr. 6990*, ndërmjet shoqërisë “AL H..... Konstruksion” Sh.p.k në cilësinë e shitësit dhe V.N, Y.B, A.H në cilësinë e blerësve, për sipërfaqen e truallit **5920 m²**, pasurisë nr. 3/22, v.13, fq.51, zk. 8210, në zbatim të nenit 39 “Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim” i ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

2- Rekomandim: Nga ZVRPP Tiranë, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **3,900,730 lekë** e shkaktuar nga mos llogaritja dhe ndalesa e taksës së kalimit të pronësisë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “*Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa*”, pika 2, ligjin nr. 9632, datë 30.10.1996 “Për Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar neni 28, pika 2, ndaj investitorëve përkatësisht si më poshtë:

- a- “N.... 10” Sh.p.k – vlera 453,800 lekë (*sip.435,8 m² x 1000 lekë/m²*)
- b- “A.....Ndërtimi” Sh.p.k - vlera 575,320 lekë (*575.32m²x1000 lekë/m²*)
- c- “I....” Sh.p.k.- vlera 2,135,510 lekë (*sip.2135.51 m² x1000 lekë/m²*)
- d- “M.....Konstruksion” Sh.p.k- vlera 754,100 lekë (*sip.754.10 m² x 1000 lekë/m²*).

3- Gjetje: Në dy raste për pasurinë nr. 3/22, v.13, fq.51, zk.8210, Q.T.R.C, në pronësi të “M..... Konstruksion”, dhe pasurinë nr. 3/348, vol. 35, fq.169, zk. 8380, në pronësi të “N.... 10” Sh.p.k, në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, i cili është përdorur për regjistrim, si dhe referuar kohës së dhënies së lejes së ndërtimit si dhe sistemit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tiranë, ka rezultuar shmangie nga tarifa e marrjes së lejes ndërtimit në nivelin 5% (*ky nivel 5 % për taksat e ndikimit në infrastrukturë dhe vlera e investimit është llogaritur në kushtet e mungesës së VKB-Tiranë, mungesës së një tabele përmbledhëse të llogaritjeve që i përgjigjet vlerës së mandatit të paguar për këto taksa, dhe dokumentacionit tjetër shoqërues në dosje, për taksa vendore të miratuara, gjithashtu ky nivel është marrë nga aplikimi në raste të ngjashme*), duke kaluar në procedura legalizimi, që ka sjellë si pasojë fshehje dhe shmangie e pagimit të vlerës së lejes së ndërtimit, ku sipas

situacionit përfundimtar, rezulton një **dëm ekonomik i konsiderueshëm në vlerë 170,007,707 lekë**, përkatësisht si më poshtë:

- Subjekti “M.....Konstruksion”, **160,332,874 lekë**,

- Subjekti “N..... 10” Sh.p.k, **9,674,833 lekë**,

vlera të cilat kanë ardhur nga kalimi në proces legalizimi nga ana e ALUIZN Tiranë, pasi ky legalizim është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, sepse nuk ka qenë ndërtimi informal, por është ndërtim i ligjshëm dhe procedurat duhet të kryheshin sipas lejes ndërtimit me Bashkinë Tiranë, sepse nuk ka shtesa të paligjshme. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, neni 51, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” .

Rekomandim: Nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të vihet në dijeni Bashkia Tiranë për shkeljet e konstatuara, e cila duhet të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **170,007,707 lekë** e shkaktuar nga shmangia nga tarifa e marrjes së lejes ndërtimit duke kaluar në procedura legalizimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, neni 51, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim informal, por është ndërtim i ligjshëm dhe procedurat duhet të kryheshin sipas lejes ndërtimit me Bashkinë Tiranë, sepse nuk ka shtesa të paligjshme.

4- Gjetje: Në **dy raste** janë shmangur pagesat për tarifatat dhe taksat e shërbimit për regjistrimin fillestarë të njërive, si më poshtë:

a- Për pasurinë nr. 3/22, v.13, fq.51, zk.8210, QTRC, në pronësi të “M.... Konstruksion”, rezulton se sipërfaqet e 6 kateve shërbimeve janë regjistruar si njësi të vetme dhe të pandara, ndërkohë që sipas planimetrisë rezulton se në **6 kat shërbime** ka gjithësej 104 njësi të ndara, për të cilat nuk është bërë pagesa e tarifave dhe taksave në vlerë **884,000 lekë**, **vlera e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**.

b- Për pasurinë nr. 3/348, vol. 35, fq.169, zk. 8380, në pronësi të “Ndërtuesi 10” Sh.p.k, kati nëntokë ka 25 njësi, për të cilat nuk është bërë pagesa e tarifave dhe taksave në vlerë **36,250 lekë**, **vlera e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**. Veprime të cilat bien në kundërshtim me ligjin 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Nga ZVRPP Tiranë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **920,250 lekë** e shkaktuar nga shmangia e pagesës për tarifatat dhe taksat e shërbimit për regjistrimin fillestarë të njërive në kundërshtim me ligjin 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, përkatësisht si më poshtë:

- “M.....Konstruksion”- vlera **884,000 lekë**,

- “N..... 10” Sh.p.k – vlera **36,250 lekë**.

5- Gjetje: ZVRPP Tiranë, për zonën 1, nuk ka ndjekur procedurat për hartimin e dokumentacionit për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt e nuk ka kryer evidentimin e raportimin e ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 lidhur me 37 vendimet marrë nga Gjykata e Shkallës Parë Administrative Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i

Vlerësimi të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë për të cilat në 8 raste ZVRPP ka qenë palë kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve të cilat i përkasin Zonës 1, të cilat i janë dërguar në ZVRPP Tiranë për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjeshme dhe regjistrim “shtet” të **30 AMTP-ve me mbi 45 pasuri** me sipërfaqe totale prej **647 660 m²** nga e cila: shlyerje të detyrimit ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej **31 255 m²** në vlerën **22,604,135 lekë**, kthim e regjistrim në pronësi “shtet” të sipërfaqes prej **332 881 m² tokë bujqësore të llojit “arë”, “vresht”, “ullishtë” dhe “pemëtore”.**

-nuk janë vendosur barrë mbi pasuritë e tjetërsuara në **9 raste për 31 255 m²**, me vlerën prej **22,604,135 lekë** (deri në përfundimin e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët me objekt vlefshmërinë e titujve të pronësisë) që ka sjellë si pasojë mos arkëtim dhe dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, nga të cilat:

në 5 raste në sipërfaqen prej 18 900 m² (është marrë Vendim Gjykatë për ti kthyer “shtet”, e për pasojë edhe kthimin e shumës koresponduese prej mbi **8,309,820 lekë, përfituar padrejtësisht sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes;**

në 2 raste ka vendim të KVVTP-së për sipërfaqen **2400 m²** dhe kthimin e shumës koresponduese **1,120,200 lekë**, në total për **7 rastet** më sipër vlera **9,430,020 lekë;**

në 2 raste me Vendim Gjykatë është rrëzuar kërkesa padia për sipërfaqet **9 955 m²** me vlerë koresponduese **13,174,135 lekë** dhe që kanë sjellë si pasojë lënien në gjendje juridike me pronësi të mbajtësit të paligjshëm dhe mos kalimin e titujve të pronësisë “Shtet”, pasqyruar në tabelën nr. “ZVRPP TIRANË Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2012-2015 ZONA nr. 1”, bashkëlidhur këtij procesverbali .

Rekomandim: ZVRPP Tiranë, Regjistruesi të kërkojë nëpërmjet rrugës ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë 9,430,020 lekë sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes për sipërfaqen 21,300 m² “Shtet”; (sipas konstatimit është lejuar tjetërsimi e shitja e pronës shtet në 7 raste në sipërfaqen prej 21,300 m² (e kthyer “shtet” në **5 raste** nga gjykata dhe në 2 raste me vendim të KVVTP-së, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëmin ekonomik në vlerën prej 9,430,020 lekë), pasqyruar në tabelën nr. “ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v.2012-2015 ZONA nr. 1.

6. Gjetje:- ZVRPP Tiranë ka regjistruar në **7 raste** (sipas të dhënave të KPP, në të gjitha rastet), pasuritë me origjina nga Lejet e Ndërtimit, duke mos regjistruar në rubrikën “Përshkrimi i veçantë” dhe kornizën “Për pjesën e përbashkët” për pallatin në tërësi dhe për çdo aksesor të tij (apartament, shesh pushimi, shkallë, ashensor, kabinë, depozita uji, sistem ngrohje, etj}, për rrjedhojë është shmangur pagesa e taksës së kalimit të pronësisë, duke shkaktuar **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 8,851,100 lekë;** ku për secilin rast llogaritet:

Pasuria nr. 158- ND, volumni 21, faqe 14, ZK 8360, në pronësi të shoqërisë “Pienvi” shpk, objekti: “Godinë banimi dhe shërbimi 1, 6 dhe 9 kat, me 2 kat parkim nëntokë”, për sipërfaqen totale të përbashkët prej **1205.8 m²**, nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj firmës “P....” shpk, për sipërfaqet e përbashkëta, në vlerën prej **1,205,800 lekë** (1205.8 m² x 1000 lekë/m² ndërtim), që përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit;**

Pasuria nr. 5/673, volumni 28, faqe 88, ZK. 8360, në pronësi të shoqërisë “F....” shpk, objekti “Godinë banimi dhe shërbimi 1, 6 dhe 9 kat, me 2 kat parkim nëntokë”, për

sipërfaqen totale të përbashkët prej $833.8 m^2$, nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj firmës “F...” shpk, për sipërfaqet e përbashkëta, në vlerën prej **833,800 lekë** ($833.8 m^2 \times 1000$), që përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit;**

Pasuria nr. 3/457, volumi 29, faqe 244, ZK8370, në pronësi të shoqërisë “S.....” shpk, objekti “Godinë banimi dhe shërbimi 4 dhe 6 kat, me 2 kat parkim nëntokë” shpk, për sipërfaqen totale të përbashkët prej $1330.1 m^2$, nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj firmës “S.....” shpk, për sipërfaqet e përbashkëta, në vlerën prej **1,330,100 lekë** ($1330.1 m^2 \times 1000 \text{ lekë}/m^2/\text{ndërtim}$), që përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit;**

Pasuria nr. 9/633, volumi 32, faqe 222, ZK 8330, në pronësi të shoqërisë “4 G....” shpk, objekti: “Godinë banimi dhe shërbimi 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë”, për sipërfaqen totale të përbashkët prej $1140 m^2$, nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj firmës “4 G....” shpk, për sipërfaqet e përbashkëta, në vlerën prej **1,140,000 lekë**, që përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit;**

Pasuria nr. 2/280-ND, volumi 12, faqe 179, ZK 8340, në pronësi të shoqërisë “S....BM” shpk, objekti: “Kompleks banimi 12 kat, me 1 kat parkim nëntokë”, për sipërfaqen totale të përbashkët prej $1016.4 m^2$, nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj firmës S.B.M shpk, për sipërfaqet e përbashkëta, në vlerën prej **1,016,400 lekë**, që përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit;**

Pasuria nr. 6/150, volumi 21, faqe 68, ZK 8360, në pronësi të shoqërisë “H....Ndërtim” shpk, objekti: “Godinë banimi dhe shërbimi 2,5,8,10 dhe 12 kat, me 2 kat parkim nëntokë”, për sipërfaqen totale të përbashkët prej $2860 m^2$, nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj firmës “H....Ndërtim” shpk, për sipërfaqet e përbashkëta, në vlerën prej **2,860,000 lekë**, që përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit;**

Pasuria nr. 10/258, volumi 27, faqe 146, ZK 8370, në pronësi të shoqërisë “N....A” shpk, objekti: “Godinë banimi dhe shërbimi 11 kat, me 1 kat parkim nëntokë”, për sipërfaqen totale të përbashkët prej $465 m^2$, nuk janë llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë ndaj firmës “N....A” shpk, për sipërfaqet e përbashkëta, në vlerën prej **465,000 lekë**, që përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit;**

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë:

Pasuria nr. 158- ND, volumi 21, faqe 14, ZK 8360, në pronësi të shoqërisë “P...” shpk., deri në arkëtimin e vlerës prej **1,205,800 lekë**, nga subjekti “P.....” shpk, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

Pasuria nr. 5/673, volumi 28, faqe 88, ZK. 8360 në pronësi të shoqërisë “F....” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **833,800 lekë**, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit

Pasuria nr. 3/457, volumi 29, faqe 244, ZK8370, në pronësi të shoqërisë “S...” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **1,330,100 lekë**, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit

Pasuria nr. 9/633, volumi 32, faqe 222, ZK 8330, në pronësi të shoqërisë “4 G.....” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **1,140,000 lekë**, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit

Pasuria nr. 2/280-ND, volumi 12, faqe 179, ZK 8340, në pronësi të shoqërisë “SBM” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **1,016,400 lekë**, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

Pasuria nr. 6/150, volumi 21, faqe 68, ZK 8360, në pronësi të shoqërisë “H...Ndërtim” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **2,860,000 lekë**, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit

Pasuria nr. 10/258, volumi 27, faqe 146, ZK 8370, në pronësi të shoqërisë “N...A” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **465,000 lekë**, për të realizuar regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta të ndërtimit.

7-Gjetje: ZVRPP Tiranë në **4 raste** ka regjistruar pasuritë, me origjinë nga Lejet e Ndërtimit, ku rezulton se pagesa e taksave të shërbimit nuk është bërë sipas përcaktimeve të VKM-së përkatëse, në momentin që realizohet shërbimi i kërkuar, për rrjedhojë taksat e shërbimit janë likuiduar në vlera më të ulëta, **duke shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën totale 2,219,500 lekë**, ku për sejcilin rast llogaritet:

- Shoqëria “P...” shpk për regjistrimin e pasurisë nr. 158- ND, volumi 21, faqe 14, ZK 8360, ka paguar më pak taksa dhe tarifa shërbimi në vlerën **350,600 lekë**,

- Shoqëria “F...” shpk, për regjistrimin e pasurisë nr. 5/673, volumi 28, faqe 88, ZK. 8360, ka paguar më pak taksa dhe tarifa shërbimi në vlerën **644,200 lekë**.

- Shoqëria “SB...M” shpk, për regjistrimin e pasurisë nr. 2/280-ND, volumi 12, faqe 179, ZK. 8340, ka paguar më pak taksa dhe tarifa shërbimi në vlerën **319,400 lekë**.

- Shoqëria “H..... Ndërtim” sh.p.k. , për regjistrimin e pasurisë nr. 6/150, volumi 21, faqe 68, ZK 8360, ka paguar më pak taksa dhe tarifa shërbimi në vlerën **905,300 lekë**.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të ndjekë të gjitha rrugët ligjore **dhe të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë:**

Pasuria nr. 158- ND, volumi 21, faqe 14, ZK 8360, në pronësi të shoqërisë “Pienvis” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **350,600 lekë**, nga subjekti “P...” shpk, për diferenca të paguara më pak për taksa dhe tarifa shërbimi.

Pasuria nr. 5/673, volumi 28, faqe 88, ZK. 8360 në pronësi të shoqërisë “F.....” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **644,200 lekë**, nga subjekti “F...” shpk, për diferenca të paguara më pak për taksa dhe tarifa shërbimi.

Pasuria nr. 2/280-ND, volumi 12, faqe 179, ZK 8340, në pronësi të shoqërisë “SBM... shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **319,400 lekë**, për diferenca të paguara më pak për taksa dhe tarifa shërbimi.

Pasuria nr. 6/150, volumi 21, faqe 68, ZK 8360, në pronësi të shoqërisë “H..... Ndërtim” shpk, deri në arkëtimin e vlerës prej **905,300 lekë**, , për diferenca të paguara më pak për taksa dhe tarifa shërbimi.

8. Gjetje: ZVRPP Tiranë ka bërë shpronësimin e pasurisë **6/136, e cila ka qenë në kushtet e kufizimit për shkak të mbivendosjes me pasuritë nr. 7/155 dhe nr. 6/136, në një sipërfaqe prej 178 m²**, gjithashtu në favor të qytetarit është shpronësuar edhe një sipërfaqe trualli prej **41 m²**, e cila rezulton në pronësi të shtetit, duke shkaktuar **dëm ekonomik të pasurisë së shtetit në vlerën 1,071,617 lekë**.

Rekomandim: ZVRPP Tiranë të marrë masa, të kërkojë shlyerje të detyrimit ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej **41 m²** në vlerën **1,071,617 lekë**, si dhe **të vendosë barrë mbi**

pasuritë 6/136, vol. 4, faqe 146, pas. Nr. 7/155, vol. 11, faqe 64, dhe Pasuria nr. 7/156, vol. 11, faqe 66, deri në shlyerje, ZK 8330, deri në shlyerjen e detyrimit dhe zgjidhjen e problemit të mbivendosjes.

9. Gjetje: ZVRPP Tiranë në 3 raste, në KKP-të, në rubrikën “Për pjesëmarrjen e përbashkët-pallat-Kuota Pjesëmarrjes” nuk janë shënuar ambjentet e përbashkëta, si dhe përqindja e pjesëmarrjes, gjithashtu nuk është bërë regjistrimi fillestar i këtyre ambjenteve, përkatësisht në sipërfaqe totale prej **4306 m²** dhe vlerë **4,306,000 lekë** dhe konkretisht:

- për subjektin ndërtues “A.... Konstruksion” shpk, sipërfaqen prej 1199.5 m², duke u vlerësuar **me një dëm ekonomik në vlerën 1,199,500 lekë** (sipërfaqja 1199.5 m² x 1000 lekë/m²), për pasurinë pallat 7/276, vol. 5, faqe 242 dhe volum 20, faqe 9 deri 120, ZK. 8170.

- për subjektin “A....” shpk në sipërfaqen prej 2051.95 m², **me një dëm ekonomik në vlerën 2,051,950 lekë** (sipërfaqja 2051.95 m² x 1000 lekë/m²), për pasurinë pallat 9/836, vol 44, faqe 206, ZK. 8120.

- për subjektin Shoqëria “W....” shpk në sipërfaqe totale prej 1054.40 m², **me një dëm ekonomik në vlerën 1,054,400 lekë** (sipërfaqja 1054.40 m² x 1000 lekë/m²), për pasurinë pallat 5/592, vol. 48, faqe 200, ZK. 8150, veprim në papajtueshmëri me kërkesat e Ligjit Nr. 10 112, datë 09.04.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.”, dhe ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 50, “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa” .

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara **të nxjerrë urdhër kufizimi** dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **4,306,000 lekë**, për subjektet ndërtuese “Alba Konstruksion” shpk, “A....” shpk dhe “W...” shpk .

10. Gjetje: ZVRPP Tiranë në 1 rast, sipas aplikimit për regjistrim të kontratës së shitjes nr. 3604 rep, nr. 987 kol, datë 22.08.1998 të noteres R.S ka munguar llogaritja e ditë vonesave në regjistrim për S.M, veprim në papajtueshmëri me nenin 38 të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Pasuritë e Paluajtshme”, detyrimet për ditë vonesa në regjistrim fillojnë nga data 19.01.1999, në bazë të Udhëzimit nr. 19, datë 19.01.1999 .

Rekomandim:

a. Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **300,000 lekë** prej zotit **S.M.**

b. ZVRPP Tiranë Regjistruesi, pasi të vendosë masë kufizimi në seksionin përkatës të KPP-ve, pra të KPP “mëmë” nr.4/83, v.31, f.124 zk.8270 truall 1260 m², me 1401 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 640 m² e llojit pallat dhe në KPP nr. 8/743, v. 31 fq.170, e llojit pallat trualli 1500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 682 m², **të kërkohet arkëtimin e vlerës 1,856,080 lekë**, përkatësisht: ndaj firmës “A...” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët prej **795,4 m²** në vlerën prej **795,400 lekë** (795,4 m² x 1000 lekë/m²/ndërtim) dhe ndaj “D....” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët **1014,69 m²** në vlerën prej **1,014,690 lekë** (1014,69 m² x 1000 lekë/m²/ndërtim), si taksë e kalimit të pronësisë e pa llogaritur dhe e paarkëtuar në momentin e regjistrimit të pallatit (vlera të cilat blerësit qytetar i kanë paguar në çmim të

blerjes së apartamenteve, garazheve) dhe të vlerës prej **45,990 lekë ndaj personave për kontrata shitje.**

c. ZVRPP Tiranë, Regjistruesi të identifikojë pasuritë objekt zona 4, të zbatojë **16 vendimet** e Gjykatës Shkallës Pare Administrative Tirane, Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë ku në **12 raste** ZVRPP ka qenë pale kërkuese, për të cilat gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve që i përkasin Zonës 4, pagimin e detyrimeve prej të cilave:

1.-Të kërkojë dhe sigurojë shlyerjen e detyrimit në vlerën prej **5,479,500 lekë** që i përket pasurive “Shtet” të tjetërsuara gjatë procesit të gjykimit në 2 raste për sipërfaqen **12 740 m² pasi të ketë vendosë barrë mbi to deri në shlyerjen e detyrimit vlerësuar nga gjykata, sipas tabelës.**“ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2012-2015 zona nr. 4”.

2. Të kërkojë nëpërmjet rrugës ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë përkatëse të tregut për sipërfaqen e shitur **prej 3500 m² “Shtet” dhe të vlerës prej 21,045,000 lekë** sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes për sipërfaqen **3000 m² pronë “Shtet”**; që i përket pasurive “Shtet” të tjetërsuara gjatë procesit të gjykimit (*sipas konstatimit -është lejuar tjetërsimi e shitja e pronës shtet ne 2 raste në sipërfaqen prej 6500 m²(sipërfaqe “shtet” kthyer nga gjykata), duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëmin ekonomik në vlerën mbi 21,045,000 lekë sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes*) pasqyruar në tabelën.“ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v.2012-2015 zona nr. 4”.

11.Gjetje: ZVRPP Tiranë në 1 rast, ka bërë regjistrimin e pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, pa llogaritur më parë penaltetet në regjistrim duke **shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë prej 300,000 lekë, veprime në kundërshtim me nenin 39 të ligjit 33/2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”** .

Rekomandim: Nga ZVRPP Tiranë të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **300,000 lekë** e shkaktuar nga mosaplikimi i penalteteve për vonesa në regjistrim për pasurinë nr. 3/320/ND, volum, 29 faqe 3, të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8230, veprime në kundërshtim me nenin 39 “Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim”, të ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

12.Gjetje: ZVRPP Tiranë në **1 rast**, ka bërë regjistrimin e pasurisë dhe është pajisur poseduesi i saj me Certifikatë pronësie, **pa administruar një titull të ligjshëm pronësor mbi sipërfaqen e pasurisë të llojit objekt**, regjistruar me nr. 3/67-ND, volum, 28 faqe 138, pasi leja e ndërtimit rezultoi e lëshuar për një subjekt të ndryshëm dhe regjistrimi është bërë për një tjetër subjekt, si dhe me mangësi dokumentare e hartografike, përsa i përket dokumentacionit të vet lejes dhe pozicionimit të ndërtimit sipas lejes dhe HTR të ZVRPP, veprime në mospërputhje me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Po ashtu është vepruar pa llogaritur më parë penaltetet në regjistrim duke **shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë prej 170,500 lekë, veprime në kundërshtim me nenin 39 të ligjit 33/2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”** .

Rekomandim: Nga ZVRPP Tiranë të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **170,500 lekë** e shkaktuar nga mosaplikimi i penalteteve për vonesa në regjistrim për pasurinë nr. 3/67-ND, volum, 28 faqe 138, të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8230,

veprime në kundërshtim me nenin 39 “Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim”, të ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **ti kërkohet Kryeregjistruesit ZQRPP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore për 30 punonjës specialistë, nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”,.

Nga ZVRPP Shkodër, nuk është kthyer përgjigje pasi është brenda afatit ligjor 20 ditë, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Selfo zeneli, Rysisn Xhaja, Luan Kuka, Qemal Meta dhe Besmir Pajaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT